

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5762  
E premte, 26 prill 2019  
çmimi 0.40 €

## Kosova, shteti i dytë i kombit shqiptar

FAQE 11

Xhavit  
HALITI



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ | FAQE 4-5



## Opozita po bën zhurmë, nuk ka zgjedhje këtë vit

- AAK-ja ka rritje  
100 për qind  
në elektorat

Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, njëherësh edhe nënkryetar i AAK-së, Pal Lekaj, nuk beson se do të ketë zgjedhje të parakohshme këtë vit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re",

ai ka thënë se nuk sheh asnjë arsye që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme. Madje Lekaj ka thënë se kjo qeveri mandatin e saj kushtetues do ta çojë deri në fund, duke theksuar se Kosova ka një

opozitë të dobët e cila më tepër po bën zhurmë dhe nuk po i argumenton kritikën ndaj qeverisë. Ai ka mohuar se ka ftohje të raporteve në mes të kryeparlamentarit Kadri Veseli dhe kryeministrit Ramush Haradinaj

## Kosnetti: Sfidë mbetet zbatimi i ligjeve në praktikë

Republika e Kosovës ka miratuar ligje të cilat janë shembull për vende të tjera, por sfida mbetet zbatimi i tyre në praktikë. Kështu ka deklaruar të enjten ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, në debatin e organizuar nga Lëvizja FOL. Ai ka thënë se për moslogaridhënie dhe moszbatim të ligjit përgjegjës janë edhe qytetarët. Diplomati amerikan ka vlerësuar se barazia ligjore dhe llogaridhënia sjellin më shumë shpresa te populli dhe japin sinjal të mirë para botës për Kosovën. Kosnett u ka bërë thirrje shoqërisë civile dhe medieve që të jenë më të zëshme në denoncimin e korrupsionit | FAQE 3



Istrefi thotë se  
Telekomit iu  
larguan 120 mijë  
klientë, kërkon  
përkrahjen e  
Qeverisë | FAQE 8

## AKTUALE

**PZAP-I URDHËRON  
KQZ-në TA CERTIFIKOJË  
LISTËN SERBE** F. 3

**KLINIKA E NEONATOLOGJISË  
BËHET ME TRE RESPIRATORË  
TË RINJ** F. 7

**MASHT-i NDËRMERR  
TË GJITHA MASAT  
PROFESIONALE DHE  
LOGJISTIKE PËR TEKSTET  
E REJA SHKOLLORE** F. 7



## EKONOMI

**BIZNESET ADRESOJNË  
PROBLEMET QË DALIN  
NGA LIGJI I RI PËR  
TREGTINË** F. 9

**KOSOVA ANËTARËSOHET  
NË UNIONIN NDËRKOMBËTAR  
PËR RUAJTJEN E NATYRËS** F. 9



## SPORT

**PILOTI POLAK DHURON  
SPEKTAKËL, UL AVIONIN NË  
PISTËN E NGUSHTË** F. 18

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



**ORGANIZATA E VETERANËVE TË LUFTËS  
TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS**



# TUBIM PËRKUJTIMOR



## ***NJOFTIM***

### **HOMAZHE DHE TUBIM PËRKUJTIMOR**

Në tre vjetorin e ndarjes nga ne e veprimtarit  
të shquar të Çështjes Kombëtare

### **SHASIVAR MAKOLLI - QALI**

Më 26 prill 2019, në ora 11:00, në Varrezat e Qytetit në Prishtinë,  
bëhen homazhe ndërsa në

ora 16:00, në Teatrin Kombëtar në Prishtinë do  
të mbahet TUBIM PËRKUJTIMOR

Prezenca juaj nderon kujtimin për ata që i kushtuan  
tërë jetën Çështjes Kombëtare Shqiptare

# Joe Biden shpall kandidaturën për president të ShBA-së



Në një video të postuar në "Twitter", ish-nën-presidenti amerikan Joe Biden shpalli zyrtarisht kandidaturën për president për zgjedhjet e vitit 2020, duke dalë menjëherë në krye të listës së gjatë të kandidatëve demokratë që duan të sfidojnë presidentin Donald Trump

WASHINGTON, 25 PRILL - Ish-nën-presidenti amerikan Joe Biden shpalli zyrtarisht të enjten kandidaturën për president për zgjedhjet e vitit 2020, duke dalë menjëherë në krye të listës së gjatë të kandidatëve demokratë që duan të sfidojnë presidentin Donald Trump.

Ai e shpalli vendimin në një video të postuar në rrjetin "Twitter", duke deklaruar se "jemi në betejë për shpirtin e këtij kombi". "Jam i bindur se këto katër vjet me këtë president dhe gjithçka që ai mbështet, do të hyjnë në histori si një moment i neveritshëm i përkohshëm, tha ai. Por nëse i

japim Donald Trumpit tetë vjet në Shtëpinë e Bardhë, ai do të ndryshojë përgjithmonë dhe rrënjësisht karakterin e këtij kombi. Nuk mund të rri e të shoh se çfarë po ndodh", tha ai. Tashmë janë bërë 20 kandidatë demokratë që luftojnë për ta fituar kandidaturën për zgjedhjet presidenciale, ndërsa emra të tjerë më pak të njohur mund t'i bashkohen garës. Biden, 76-vjeçar, një senator veteran nga shteti Delaware dhe nën-president për dy mandate në administratën e ish-presidentit Barack Obama, përballtet me kandidatët e tjerë demokratë, përfshirë senatorin nga

Vermonti, Bernie Sanders i cili kryeson shumë anketa dhe ka shfaqur aftësinë për të siguruar fonde.

Mes demokratëve, Biden ka përvojë ndërkombëtare dhe legislative të pasqyruara dhe është ndër fytyrat më të njohura në politikën e Shteteve të Bashkuara. Por stili i tij të komunikimit, që i ka kaluar koha dhe që shprehet me afërsi fizike që mund të konsiderohet e papërshtatshme, së fundmi i ka shkaktuar atij probleme, kur të paktën shtatë gra, përfshirë një ish-kandidate për zëvendës guvernatore e Nevadës, e akuzuan atë për prekje, përqafime dhe puthje të papërshtatshme në aktivitete publike. Biden e mbrojti sjelljen e tij duke thënë se përputhej me përpjekjet e tij gjatë jetës për të krijuar "lidhje njerëzore" si me gra, ashtu edhe me burra dhe premtoi se këtej e tutje do të jetë i kujdesshëm ndaj asaj

kufijve të afërsisë të njerëzve të tjerë.

Biden ka një aftësi që shumë prej rivalëve të tij u mungon - mbi një shekull përvojë në qeveri dhe një histori të gjatë vendimesh politike - disa prej të cilave në nivelet më të larta të qeverisë. Ai ishte senator për afro katër dekada, duke u bërë kryetar i Komisionit Juridik dhe atij për Marrëdhënie me Jashtë. Më pas ai ishte nën-president për tetë vjet gjatë presidencës Obama. Ai mbështeti disa ndërhyrje të huaja të Shteteve të Bashkuara, përfshirë luftën në Afganistan në vitin 2001 dhe ndërhyrjen në Irak në vitin 2003, dhe kishte një rol të rëndësishëm në miratimin e legjislacionit për kontrollin e armëve, si edhe për reformimin e sistemit të drejtësisë kriminale. Megjithatë, me ndryshimin e kohëve dhe vlerave politike, disa nga vendimet dhe veprimet e Bidenit janë kritikuar nga

demokratët dhe të pavarurit më liberalë. Disa në Partinë Demokratike mendojnë se karriera e Bidenit në Uashington do të ndihmojë për t'i bindur votuesit që mund ta mundë presidentin Trump vitin e kaluar, por të tjerë argumentojnë se partisë i duhet një fytyrë e re.

Kur ishte vetëm 29 vjeç në vitin 1972, Biden fitoi zgjedhjet për t'u bërë senatori i dytë më i ri në historinë amerikane. Vetëm disa javë më pas, gruaja e tij Neilia, dhe vajza e tij e vogël, Naomi, humbën jetën në një aksident rrugor, një javë para Krishtlindjeve. Djemtë e tij, Beau and Hunter, u plagosën rëndë por mbijetuan dhe Biden e bëri betimin si senator pranë shtratit të spitalit të të birit Beau në vitin 1973.

Mbi 40 vjet më pas, Biden që ishte rimartuar prej kohësh me Jill Biden, u godit përsëri nga tragjedia, kur Beau vdiq nga kanceri në tru në moshën 46-vjeçare.

Biden përmendi vdekjen e tij si arsye që nuk hyri në garën presidenciale në vitin 2015.

Joel Goldstein, profesor në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Saint Louis-it, i tha "Zërit të Amerikës" se mënyra se si u përball me tragjeditë është tregues "i aftësisë së tij për t'u rimëkëmbur, karakterit dhe forcës" së tij.

Për 36 vjet në Senat, Biden pothuajse çdo ditë merrte trenin nga Delaware në Uashington, një distance mbi 100 kilometra. Ai gjithmonë ka mbështetur bashkëpunimin partiak, që mund të shihet si forcë ose si dobësi. Në mars, Biden tha se nën-presidenti Mike Pence është "njeri i mirë", por u tërhoq më pas, pasi u kritikua nga e majta për shkak të qëndrimit të Pence ndaj të drejtave të komunitetit LGBTQ.

## Basha: Nuk ka zgjedhje më 30 qershor

TIRANË, 25 PRILL - Lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, tha në protestën e së enjtes se nuk do të ketë zgjedhje më 30 qershor dhe se opozita as nuk klonohet dhe as nuk shpiket. "Më 30 qershor nuk ka për të pasur zgjedhje në Shqipëri. Këtë e di edhe bufi, edhe vëllai i bufit Edi Rama. Opozita as nuk klonohet, as nuk shpiket dhe as nuk krijohet siç krijohen shërbëtorët dhe mercenarët e Edi Ramës", deklaroi Basha. "Le ta dijë mirë Edi Rama, shërbëtorët dhe

mercenarët e tij, në burg do të shkojë Vangjush Dako, Damian Gjilnuri dhe të gjithë bashkëpunëtorët politikë të Edi Ramës që janë kapur duke vjedhur votën e shqiptarëve", tha Basha.

Ndërkaq, kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi tha nga Durrësi, se protestat e opozitës do të jenë të befasishme, duke shtuar se ende nuk ka filluar mosbindja civile. "Ka një pjesëmarrje të madhe, kanë ardhur kaq shumë njerëz

dhe duke menduar që kjo është një nga rrugët kryesore. Sot Shqipëria merr mesazh dhe shpërndan atë ndjenjë proteste që bëjnë qytetarët në protestat e Tiranës, tashmë shpërndahen në të gjithë Shqipërinë, për të gjithë ata që nuk e kanë mundësinë financiare për të ardhur në protestat që organizohen në Tiranë, sepse pjesa më e madhe ka qenë me qytetarët e kryeqytetit. Por, ne tashmë do të shpërndahemi në të gjithë Shqipërinë", tha Kryemadhi.



Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett, ka marrë pjesë në debatin e organizuar nga Lëvizja FOL

## Kosnetti: Sfidë mbetet zbatimi i ligjeve në praktikë

Republika e Kosovës ka miratuar ligje të cilat janë shembull për vende të tjera, por sfidë mbetet zbatimi i tyre në praktikë. Kështu ka deklaruar të enjten ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, në debatin e organizuar nga Lëvizja FOL. Ai ka thënë se për moslogaridhënie dhe moszbatim të ligjit përgjegjës janë edhe qytetarët. Diplomati amerikan ka vlerësuar se barazia ligjore dhe llogaridhënia sjellin më shumë shpresa te populli dhe japin sinjal të mirë para botës për Kosovën. Kosnett u ka bërë thirrje shoqërisë civile dhe medieve që të jenë më të zëshme në denoncimin e korrupsionit



ç'rast ka lavdëruar institucionet e Kosovës për miratimin e shumë ligjeve të cilat, sipas Kosnetit, janë shembull edhe për vende të tjera. Megjithatë, ai ka thënë se në shtetin e Kosovës sfidë mbetet zbatimi i ligjeve në praktikë. Sipas ambasadorit amerikan për moslogaridhënie dhe moszbatim të ligjit përgjegjës janë edhe qytetarët e Kosovës. "Është përgjegjësi e qytetarëve për të marrë pjesë dhe për të siguruar që të gjithë njerëzit dhe institucionet i nënshtrohen dhe i japin llogari ligjit që bazohet në mënyrë të drejtë. Senatori dhe prokurori Robert Kenedi ka thënë se 'madhështia e ligjit është krijuar jo vetëm përmes kushtetutës, gjykatës

dhe zyrtarëve të ligjit, por nga burrat dhe gratë që përbëjnë shoqërinë tonë'. E pranoj se respektimi i ligjit paraqet vetëm një element të drejtësisë. Në disa vende njerëzit rriten me idenë se t'u ofrosh mundësi familjarëve është më e rëndësishme se çdo ligj. Këtu ndoshta do të ishte vend i mirë të them se ShBA-ja ende përpëlitet për ta ndërtuar një shoqëri ku banorët janë të bindur se me ligj garantojnë të drejta të barabarta", është shprehur ai, duke shtuar se në një shoqëri të drejtë njerëzit ndiejnë se ka ndarje të barabartë.

Ambasadori amerikan Philip Kosnett ka thënë se Kosova ka arritur shumë, por i mbetet edhe

shumë punë për të bërë. "Derisa Kosova po hyn në dekadën e dytë të pavarësisë ka ligje të shëndosha që sigurohen me Kushtetutë. Kosova po mahnit botën sa i përket transparencës në prokurim publik. Qytetarët e Kosovës mund të krenohen me shumëçka, por kanë edhe shumë punë për të bërë", ka theksuar ai.

Ndërkaq sa iu përket praktikave të këqija, Kosnetti ka marrë shembull rastin e veteranëve të rrejshëm për të cilët ka thënë se janë shndërruar në përfitues të shumë përfitimeve. Madje ai ka hedhur dyshime se mund të manipulohet edhe në rastin e përfitimit të statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. "Të mbijetuarit kanë filluar të lajmërohen 20 vjet pas luftës. A i kanë dëgjuar deputetët ata që janë prekur më së shumti nga ky ligj? Dhe a do t'i japë Kuvendi të njëjtat përfitime si veteranëve që numri i tyre është shtuar jashtëzakonisht shumë dhe në mënyrë të dyshimtë", ka thënë Kosnett.

Në këtë debat ambasadori amerikan ka përmendur edhe punësimin e njerëzve mbi bazën e përkatësisë partiake e familjare dhe jo mbi bazën e meritave. "Në Kosovë njerëzit marrin pozita qeveritare jo pse kanë kualifikime, por pse janë të lidhur familjarisht. Një anketë e kohëve të fundit nxori se 20 për qind e të anketuarve mendojnë se meritat janë çelës për hapjen e vendeve të punës në vend. Respektimi i ligjit bën që qytetarët të fitojnë drejtpërdrejt e jo vetëm disa politikanë në Prishtinë", ka theksuar diplomati amerikan.

Gjithashtu, ambasadori Kosnett ka cekur edhe rastin e tokës së Manastirit të Deçanit, duke thënë se Gjykata Kushtetuese ka konfirmuar se kisha ka pronësi disa parcela, por zyrtarët komunalë me mbështetjen e disa zyrtarëve qeveritarë e kanë kontestuar vendimin e Kushtetueses. "Vendimet e gjykatave nuk u nënshtrohen interpretimeve apo edhe më pak negociatave politike", ka thënë Kosnett.

**EPOKA  
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 25 PRILL - Ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett, ka thënë të enjten se shoqëria civile dhe mediet duhet të jenë më të zëshme në denoncimin e korrupsionit, padrejtësisë dhe pabarazisë në shoqëri. Ai ka thënë se barazia ligjore dhe llogaridhënia sjellin më shumë shpresa te populli dhe japin sinjal të mirë para botës për Kosovën. "Ka shumë mjete në demokraci të cilat qytetarët i kanë në dispozicion për t'i sfiduar vendimet e qeverisë të cilat i konsiderojnë të padrejta.

Edhe protestat paqësore janë mjete që sot përdoren në shoqëritë demokratike për t'i sfiduar vendimet e padrejta të qeverive. Andaj, është me rëndësi që shoqëria civile dhe mediet ta luajnë rolin e tyre. Nëse shoqëria civile dhe mediet janë më të zëshme, edhe ndryshimet mund të ndodhin", ka deklaruar ambasadori Kosnett në debatin me temë: "Avancimi i sistemit të drejtësisë në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës" të organizuar nga Lëvizja FOL.

Diplomati amerikan në këtë debat kryesisht ka folur për aspektin e sundimit të ligjit, me



## PZAP-i urdhëron KQZ-në ta certifikojë Listën Serbe

PRISHTINË, 25 PRILL (ER) - Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ka urdhëruar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) që ta certifikojë subjektin politik Lista Serbe për zgjedhjet e jashtëzakonshme që do të mbahen në komunat veriore më 19 maj. Por,

PZAP hodhi poshtë apelin e partisë Lista Serbe, e cila kërkoi njoftimin e Prokurorisë, pasi pretendonte se moscertifikimi i saj nga anëtarët e KQZ-së përbën vepër penale. KQZ-ja ka afat 24 orë për t'u ankuar ndaj këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Më 14 prill, katër kandidatët e subjektit politik, Lista Serbe, nuk u certifikuan nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kjo për shkakun se dy anëtarët e këtij trupi nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Nazlie Balaj dhe Adnan Rustemi abstenuan në votim,

duke pamundësuar certifikimin. Lista Serbe më pas ushtroi të drejtën e ankesës në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia. Kryetarët e komunave veriore: Zubin Potok, Zvečan, Mitrovicë e Veriut dhe Leposaviq më 26 nëntor të vitit të kaluar dhanë dorëheqje në

shenjë pakënaqësie për vendosjen e taksës doganore prej 100 përqindësh nga Qeveria e Kosovës ndaj mallrave serbe. Më pas, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, caktoi datën 19 maj për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme në katër komunat veriore.

Flet për "Epokën e re", Pal Lekaj

# Opozita po bën zhurmë,



## - AAK-ja ka rritje 100 për qind në elektorat

Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, njëherësh edhe nënkryetar i AAK-së, Pal Lekaj, nuk beson se do të ketë zgjedhje të parakohshme këtë vit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se nuk sheh asnjë arsye që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme. Madje Lekaj ka thënë se kjo qeveri mandatin e saj kushtetues do ta çojë deri në fund, duke theksuar se Kosova ka një opozitë të dobët e cila më tepër po bën zhurmë dhe nuk po i argumenton kritikën ndaj qeverisë. Ai ka mohuar se ka ftohje të raporteve mes kryeparlamentarit Kadri Veseli dhe kryeministrit Ramush Haradinaj

mbahen kur të përfundojë mandati kushtetues dhe jo më herët. Opozita çdoherë tenton që të ketë zgjedhje por, siç e kam thënë më herët, mendoj se e kemi një opozitë të dobët e cila më tepër po bën zhurmë dhe nuk po i argumenton kritikën dhe kërkesat e veta", ka deklaruar Lekaj. Ai ka mohuar pretendimet e medieve, se kryeparlamentari Veseli dhe kryeministrit Haradinaj i kanë ftohur raportet. Lekaj, i cili së fundi i ka pritur në konakun e tij të dy liderët e koalicionit, ka thënë se raportet e kryeparlamentarit dhe kryeministrit janë të shkëlqyeshme. "Më besoni se nuk është vërejtur asnjë ftohje e raporteve në mes të z. Veseli dhe z. Haradinaj. Përkundrazi, ata janë miq të mirë, funksionojnë

shkëlqyeshëm dhe komunikojnë shumë mirë mes vete. Nuk ka asnjë vështirësi në komunikimin e tyre", është shprehur ai. Nënkryetari i AAK-së ka thënë se kjo parti asnjëherë nuk do t'i provokojë zgjedhjet e reja, ani pse ato i konvenojnë. "Asnjëherë nuk na ka shkuar ndërmend që të shkojmë në zgjedhje dhe ta prishim kontratën, ani pse AAK-ja ka një rritje 100 për qind në elektorat. Do të jemi seriozë deri në fund dhe do ta respektojmë marrëveshjen", është shprehur ai.

**"Epoka e re":** Z. Lekaj, opozita po shprehet e bindur se më së largu zgjedhjet e parakohshme do të mbahen në vjeshtë. Si i keni parë këto paralajmërime?  
**Lekaj:** Mendoj se vetë pozicioni i

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 25 PRILL - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, njëherësh nënkryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka bërë me dije se ky koalicion qeverisës mandatin e tij do ta çojë deri në

fund, duke mohuar mundësinë e zgjedhjeve të reja këtë vit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Lekaj ka thënë se nuk sheh asnjë arsye që vendi mund të shkojë në zgjedhje të parakohshme këtë verë apo vjeshtë. "Koalicioni qeverisës ka lidhur një kontratë e cila parashihet që zgjedhjet mund

të mbahen pas katër vjetëve. Tani nuk shoh asnjë arsye dhe asnjë argument që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme", ka thënë ai. Lekaj ka theksuar se kërkesa e opozitës për zgjedhje të reja është joserioze. Sipas tij, subjektet opozitare kritikojnë ndaj qeverisë i kanë të paargumentuara. "Zgjedhjet e ardhshme do të

# nuk ka zgjedhje këtë vit

**"Epoka e re":** Zgjedhjet e parakohshme për në vjeshtë nuk i kanë përjashtuar edhe disa zëra brenda koalicionit qeverisës?

**Lekaj:** Çfarëdo zëra që janë ata, mendoj se janë zëra demokratikë. Koalicioni qeverisës ka lidhur një kontratë që parasheh se zgjedhjet mund të mbahen pas katër vjetëve. Tani nuk shoh asnjë arsye dhe asnjë argument që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme.

**"Epoka e re":** Çfarë ju shtyn të besoni se ky koalicion mund ta çojë deri në fund mandatin?

**Lekaj:** Besoj në punën e ndershme të qeverisë dhe angazhimin e saj të madh në të gjitha segmentet e jetës. Besoj në vendimet e mëdha që po i merr kjo qeveri, të cilat janë në favor të qytetarëve. Me bindje ju them se deri më tani nuk ka pasur Kosova qeveri më efektive për marrje të vendimeve të guximshme, të cilat kanë pasur për qëllim ta forcojnë shtetin e Kosovës. Ju e dini se për cilat vendime po flas, duke filluar prej atij për formimin e ushtrisë, vendimin për taksën ndaj mallrave serbe, Ligjin për Trepçën, marrëveshjen me "Contour Global" që na bënë të jemi liderë për energji elektrike. Pastaj vendimet për reforma në administratën shtetërore, Ligji për pagat dhe shumë segmente të tjera që na bëjnë të jemi mirë para qytetarëve. Mos të flasim për infrastrukturë, sepse mund të them se jemi liderë në rajon.

**"Epoka e re":** Gjasat për zgjedhje janë shtuar pas ftohjes së raporteve mes kryeparlamentarit Veseli dhe kryeministrit Haradinaj për çështjen e taksës. A janë përmirësuar raportet mes tyre?

**Lekaj:** Mund të them se asnjë ftohje të raporteve mes këtyre dy liderëve nuk ka. Kjo po dëshmohet çdo ditë. Komunikimi mes tyre është shumë korrekt. Kjo është parë edhe në praktikë, ku në qeveri çdo vendim merret në mënyrë unanime. Nuk e di se si kjo mund të quhet ftohje të raporteve mes dy liderëve.

**"Epoka e re":** Por, Veseli e Haradinaj së bashku në publik kohët e fundit janë parë shumë rrallë. Madje, pas një kohe, bashkë janë parë në konakun tuaj me rastin e festës së Pashkëve. Si ka qenë komunikimi i tyre në këtë drejtë?

**Lekaj:** Më besoni se nuk është vërejtur asnjë ftohje e raporteve në mes të z. Veseli dhe z. Haradinaj. Përkundrazi ata janë miq të mirë, funksionojnë shkëlqyeshëm dhe komunikojnë shumë mirë mes vete. Nuk ka asnjë vështirësi në komunikimin

e tyre.

**"Epoka e re":** A do të thotë kjo se mospajtimet për taksën ndaj mallrave serbe janë tejkaluar tashmë nga partnerët e koalicionit?

**Lekaj:** Mendoj se është një pozicion i PDK-së dhe kryeparlamentarit Veseli për pezullim të takës mirëpo, siç e keni parë, kjo çështje më nuk është aktuale. Ne po vazhdojmë agjendën tonë të përditshme. Mendoj se është shembull i demokracisë që të ketë mendime të ndryshme brenda koalicioni qeverisës.

**"Epoka e re":** Shumë zyrtarë të

AAK-së kanë thënë se tani për tani më së shumti zgjedhjet i konvenojnë këtij subjekti politik. A mund të presim që pikërisht AAK-ja ta provokojë mbajtjen e zgjedhjeve të reja?

**Lekaj:** Është fakt që AAK-ja ka një rritje enorme të fuqisë elektorale. Në bazë të hulumtimeve të opinionit për çdo muaj trendi i shigjetës është pozitiv, pra në ngritje. Mendoj se asnjëherë në historinë e saj AAK-ja nuk ka qenë më mirë, mirëpo ne do ta respektojmë marrëveshjen e koalicionit dhe do ta zbatojmë kontratën që kemi me partnerët tanë. Asnjëherë nuk na ka shkuar ndërmend që të shkojmë në

zgjedhje dhe ta prishim atë kontratë, ani pse AAK-ja ka një rritje 100 për qind në elektorat. Do të jemi seriozë deri në fund dhe do ta respektojmë marrëveshjen.

**"Epoka e re":** Çfarë mendoni se ka ndikuar më së shumti që të rritet besimi i qytetarëve ndaj AAK-së?

**Lekaj:** Ajo që ka ndikuar më së tepërmi besoj se është qëndrueshmëria dhe këmbëngulja e kryeministrit Haradinaj për vendimet që shkojnë në forcim të shtetit, siç ka qenë ushtria, taksat ndaj mallrave serbe dhe vendimet e tjera që i përmenda më herët.

## Këshilltari i kryeministrit Haradinaj ndalohet nga policia serbe

PRISHTINË, 25 PRILL (ER) - Partia Liberale Serbe e Kosovës ka njoftuar të enjten se në vendkalimin kufitar në mes të Kosovës dhe Serbisë në Dheun e Bardhë është ndaluar nga ana e policisë serbe, Srdjan Jovanović, anëtar i Partisë Liberale Serbe, njëherësh këshilltar i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj. Institucionet e Kosovës kanë reaguar menjëherë përmes rrjeteve sociale. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se ky rast dëshmon qartë se metodat e frikësimit që përdoren nga autoritetet serbe janë një shenjë agresioni karshi qytetarëve të Kosovës. "Shpreh shqetësimin për ndalimin e këshilltarit tim

Srdjan Jovanović nga autoritetet e sigurisë dhe inteligjencës serbe. Ky ndalim, që nuk është i pari i kësaj natyre, edhe një herë dëshmon qartë se metodat e frikësimit që përdoren nga autoritetet serbe janë një shenjë agresioni karshi qytetarëve të Kosovës. U bëjmë thirrje autoriteteve të Brukselit zyrtar që të reflektojnë dhe adresojnë, sjelljen e autoriteteve serbe ndaj qytetarëve të Kosovës. Ky agresion nuk i ndihmon normalizimit të marrëdhënieve mes shteteve tona", ka thënë kryeministri Haradinaj. Akti i ndaljes së Srdjan Jovanović nga ana e autoriteteve serbe, sipas kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka për qëllim nxitjen e urrejtjes dhe pasig-

urisë te serbët e Kosovës. "Ndalimi dhe marrja në pyetje nga autoritetet e Serbisë të një zyrtari tjetër të Partisë Liberale Serbe, Srdjan Jovanović, e që është edhe anëtar i Qeverisë së Republikës së Kosovës, është veprim i papranueshëm dhe që synon t'i përndjekë serbët e Kosovës që duan të integrohen në shtetin tonë. Ky është një akt që ka për qëllim nxitjen e urrejtjes dhe pasigurisë te serbët e Kosovës. Bashkimi Evropian duhet të reagojë dhe të kërkojë nga Serbia që t'i ndalë këto veprime provokuese. Këto akte dëshmojnë mungesë të vullnetit të Serbisë për të dialoguar e për t'u pajtuar. Veprime të tilla nuk duhet të përsëriten më", ka thënë Veseli.



opozitës i shtyn ta thonë këtë gjë. Qytetarët ua kanë dhënë besimin që ata të kritikojnë dhe ta monitorojnë sistemin, por në anën tjetër qytetarët na kanë dhënë ne mundësinë që të qeverisim vendin dhe të jemi në shërbim të qytetarëve. Zgjedhjet e ardhshme do të mbahen kur të përfundojë mandati kushtetues dhe jo më herët. Opozita çdoherë tenton që të ketë zgjedhje por, siç e kam thënë më herët, mendoj se e kemi një opozitë të dobët e cila më tepër po bën zhurmë dhe nuk po i argumenton kritikën dhe kërkesat e veta. Çdo ditë po e shoh që edhe Vetëvendosje po bën zhurmë për sektorët ku po punohet më së tepërmi dhe këtë po e bën për t'i minimizuar sukseset tona, mirëpo ne nuk do të ndalemi së punuari për të mirën e qytetarëve të vendit.

## 150 euro dënimi nëse nuk e respektoni shenjën e kuqe në semafor

PRISHTINË, 25 PRILL (ER) - Policia e Kosovës (PK) ka bërë me dije se është duke vazhduar me aktivitete që kanë për qëllim ngritjen e vazhdueshme të sigurisë në trafikun rrugor si dhe uljen e aksidenteve. Sipas një njoftimi për media, njësitë policore, përveç pikave të kon-

trollit të automjeteve apo patrullimeve në lëvizje, janë duke u përqendruar në identifikimin dhe ndëshkimin e kundërvajtësve të cilët rrezikojnë sigurinë në trafikun rrugor, në fokus janë kundërvajtësit të cilët nuk ndalen në shenjën e dritës së kuqe në vendin ku

trafiku rregullohet me semafor. Mosndalja në shenjën e dritës së kuqe në vendin ku trafiku rregullohet me semafor, parashihen këto masa për kundërvajtësin: 150 euro gjobë, tre muaj ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik si dhe tri pikë negative.



## Dr. Shukrije Rama përfaqëson Kosovën në konferencën për shkencat e edukimit në Tunizi

PRISHTINË, 25 PRILL (ER) - Organizuar nga American - Eurasian Network for Scientific Information gjatë javës së tretë të muajit prill në Tunis të Tunizisë së Afrikës Veriore është organizuar konferenca botërore qëllimi i së cilës ishte të ofrojë një forum gjithëpërfshirës global me ekspertë botërorë të komunitetit akademik për të shkëmbyer ide dhe për t'i paraqitur rezultatet e hulumtimeve në fushën e shkencave të edukimit.

Në këtë konferencë, nga Kosova ishte e ftuar dr. Shukrije Rama, e cila ishte përzgjedhur nga Këshilli Organizativ i konferencës si ligjëruese kryesore, me ç'rast trajtesa e saj ka përcaktuar temën qendrore të kësaj konference. Tema e cila u prezantua nga dr. Rama titullohej: "Performanca e profesorëve për mësimdhënie efektive". Dr. Shukrije Rama edhe më herët ka përfaqësuar Kosovën në nivel botëror në fushën akademike. Vitin e kaluar dr.

Rama ka përfaqësuar Kosovën në Universitetin e Libanit, në Beirut, me ligjëratën e saj akademike me temën "Transformimi digjital në arsim", pastaj në Universitetin e Edukimit në Lahore të Pakistanit ka prezantuar temën "Shkenca përtej klasave", ndërkaq në Pekalongan të Indonezisë ka prezantuar temën "Qëndrimet e studentëve ndaj arsimit të lartë" si dhe në universitete të tjera në Evropë e përtej.



## Koordinatori Hoti takohet me kryetarin e Bashkisë së Durrësit

DURRËS, 25 PRILL (ER) - Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Hoti, të enjten është takuar me kryetarin e bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako, me të cilin kanë biseduar për Programin Nacional dhe Ndërshtetëror për Rininë.

Koordinatori Hoti gjatë këtij takimi shpalosi Programin Nacional për Rininë duke potencuar që nxënësit përmes garave do të përfitojnë si pjesë të shpërblimeve edhe vizitat, ekspeditat dhe ekskursionet në vendet historike. "Duke e ditur se Durrësi si qytet përfaqëson vlerat historike dhe turistike për mijëvjeçarin e qytetërimit tonë, nxënësit tanë do ta vizitojnë dhe do të njihen drejtpërdrejt me vlerat, kulturën që përfaqëson ky qytet. Nëpërmjet këtyre vizitave do ta zgjerojmë bashkëpunimin ndërmjet brezit të ri pasi që



sigurisht ata do të njihen dhe do të shoqërohen gjatë këtyre vizitave nga përfaqësuesit e institu-

cioneve publike e kulturore të Durrësit", ka thënë Koordinatori Hoti.

Në anën tjetër, kryetari i Bashkisë Dako shprehu interesimin dhe gatishmërinë për pro-

gramin, duke thënë se kjo, pos që do të jetë në të mirën e nxënësve, do të jetë edhe urë lidhëse në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. "Unë zotohem se gjatë çdo vizite të bërë nga nxënësit jo vetëm në Durrës, por në të gjitha vendet si ato historike, kulturore, arkeologjike do të jem shoqërues i tyre. Ne do të angazhohemi në mënyrë të fuqishme që t'i mbështesim nxënësit nga Kosova që jo vetëm ta shijojnë këtë qytet të lashtë historik, por edhe të kenë mundësinë t'i zgjerojnë njohuritë e tyre mbi të kaluarën dhe mbi antikitetin e Durrësit", ka thënë kryetari i Bashkisë, Vangjush Dako. Në kuadër të bashkëpunimit, koordinatori Hoti dhe kryetari i Bashkisë Dako u pajtuan që në një të ardhme të afërt të nënshkruajnë marrëveshje konkrete, që do ta rrisë bashkëpunimin mes dy vendeve.

## Ministri Mustafa: Është ngritur cilësia e dizajnit të kopertinës së pasaportave

PRISHTINË, 25 PRILL (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Ekrem Mustafa, së bashku me drejtorin e Agjencisë për Regjistrim Civil, Bekim Hoxha, të enjten kanë vizituar Departamentin për Prodhimin e Dokumenteve që funksionon në

kuadër të kësaj agjencie. Me këtë rast, ministri Mustafa ka thënë se Ministria e Punëve të Brendshme vazhdimisht punon që të ofrojë sa më shumë shërbime cilësore për qytetarët e vendit. Ai ka theksuar se pajisja me dokumente personale bëhet

konform standardeve ndërkombëtare dhe garantohet nivel i lartë i sigurisë. "Pas shqyrtimit të ankesave nga qytetarët, prej muajit mars kemi ngritur cilësinë e dizajnit të kopertinës së pasaportave", ka deklaruar ministri Mustafa.



# MAShT-i ndërmer të gjitha masat profesionale dhe logjistike për tekstet e reja shkollore

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 PRILL - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka mbajtur të enjten konferencë për media lidhur me procesin e teksteve të reja shkollore, me ç'rast janë dhënë informata për ecurinë e procesit në të dyja fazat, të cilat janë zhvilluar në formë të kompleksit. Ministri Bytyqi ka bërë me dije se MAShT-i ka bërë thirrje publike për recensentët e dorëshkrimeve edhe pse, në bazë të ligjit, recensentët mund të emërohen drejtpërdrejt dhe për këtë është formuar një komision profesional. Ai ka theksuar se të gjitha dorëshkrimet të cilat kanë qenë pjesë e këtij procesi

kanë qenë të koduara dhe do të vazhdojnë të jenë deri në përfundim të procesit, ndërkaq ka shtuar se tekstet e përzgjedhura fillimisht do të pilotohen.

Po ashtu, ministri Bytyqi ka bërë me dije se organizmi i komplekseve ku është bërë vlerësimi i dorëshkrimeve nuk ka tejkaluar planifikimin buxhetor. "Buxheti nga ana e KEPSH-së ka rezultuar pozitiv. Jemi nën koston e buxhetimit i cili ka qenë i planifikuar. Kemi shpenzuar shumë më pak sesa kemi planifikuar dhe në mënyrën më të mirë është ruajtur paraja publike. Jemi munduar të krijojmë kushte sa më të mira për recensentët. Faza e parë ku është punuar në tekstet e klasave 1, 6 dhe 10 ka kushtuar 27 480 euro,



faza e dytë ku është punuar me tekstet e klasave 2, 7 dhe 11 ka kushtuar 34 260 euro, ndërsa faza e tretë që është organizuar

në 'Emerald' ka kushtuar 12 564 euro", ka thënë ministri Bytyqi. Ai ka thënë se MAShT-i ka marrë të gjitha masat profesionale dhe

logjistike që procesi të shkojë sa më mirë dhe mbarë, duke qenë të vetëdijshëm për ndjeshmërinë e procesit.

# Klinika e Neonatologjisë bëhet me tre respiratorë të rinj

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 PRILL - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, dhe drejtori i Shërbimit Spitalor dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK), Basri Sejdiu, kanë vizituar të enjten Klinikën e Neonatologjisë ku janë dorëzuar zyrtarisht tre respiratorë, të cilët do të ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë gjatë trajtimit të foshnjave të porsalindura me probleme shëndetësore.

Respiratori është një pajisje që mbështet foshnjat që kanë nevojë më të lartë të oksigjenit dhe presioneve për shkak të infeksioneve të ndryshme apo anomalive të lindura si dhe foshnjat e lindura para kohe.

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se në mungesë të aparaturave mjekësore, në veçanti në Klinikën e Neonatologjisë, shpeshherë mjekët nuk kanë mundur t'u japin trajtimin e duhur shëndetësor foshnjave. "Në



kuadër të furnizimit me pajisje të reja që kemi bërë gjatë gjithë vitit në këtë klinikë, tani kemi dorëzuar edhe tre respiratorë në vlerë prej 43 mijë eurove, për trajtimin e foshnjave të porsalindura me probleme shëndetësore. Këto aparatura do ta rrisin cilësinë e trajtimit,

në veçanti të foshnjat që kanë problem me mushkëri apo zemër. Këtë vit kemi kontraktuar edhe shumë pajisje të tjera për këtë klinikë për të siguruar shëndet për fëmijët tanë", ka thënë Ismaili. Drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, ka premtuar se në Klinikën e

Neonatologjisë do të ketë edhe investime të tjera, në mënyrë që foshnjat të kenë trajtim sa më dinjitoz. "Kemi investuar në pajisje në Klinikën Neonatologjisë, po ashtu në infrastrukturë. Do të ketë edhe investime të tjera në aparaturë, infrastrukturë dhe staf profesion-

al. Me këtë do të ofrohen kushte më të mira të punës, që mundësojnë edhe nivel më të mirë profesional dhe foshnjat të kenë një përkujdesje më të madhe", ka theksuar Sejdiu.

Drejtori i Klinikës së Neonatologjisë, Xhevdet Gojnovci, ka thënë se aparatura e re e bën më të lehtë punën e stafit mjekësor dhe ofron tretman më të mirë për fëmijët e sëmurë. "Ardhja e pajisjeve të reja e lehtëson punën sepse shpesh në mungesë të pajisjeve, më herët kemi pasur më të vështirë trajtimin e foshnjave me probleme shëndetësore. Tash nuk kemi këso probleme dhe ardhja e aparaturës së re e rrit shumë cilësinë e shërbimeve", ka thënë Gojnovci.

Ministria e Shëndetësisë dhe ShSKUK-ja kanë hartuar politika konkrete për investime në pajisje, në përpunje me nevojat e klinikave dhe spitaleve regjionale, me synim të përmirësimit të kushteve rreth ofrimit të shërbimeve për pacientin.

## Kurti dhe Konjufca paditin Thaçin e Veselin

PRISHTINË, 25 PRILL - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, dhe shefi i grupit parlamentar i kësaj lëvizjeje, Glauk Konjufca, kanë ngritur kallëzim penal ndaj presidentit Hashim Thaçi dhe kryeparlamentarit Kadri Veseli për shkak të deklaratave të tyre gjatë

dëshmimeve në rastin e "Syrin të Popullit". "Këtë kallëzim penal po e bëjmë sot duke pasur parasysh deklaratimet e rrejshme nën betim që këta dy i kanë bërë më 28 dhjetor të vitit të kaluar në procesin gjyqësor kundër të ashtuquajturit organizatë 'Syri i Popullit', me

rastin e sulmit që kanë bërë këta dy krerë institucionesh kundër Glaukut, meje dhe Sadri Ramabajës. Ata kanë dhënë deklarata të rrejshme dhe këtë e kanë bërë nën betim, prandaj ne po bëjmë sot kallëzim penal", ka thënë Kurti.





# Istrefi thotë se Telekomit iu larguan 120 mijë klientë, kërkon përkrahjen e qeverisë



Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, ka bërë me dije se si pasojë e mungesës së kontratës për sistemin e mirëmbajtjes, Telekomit i janë larguar rreth 120 000 klientë. Ai ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të jetë garantuese për një garanci bankare në vlerë 6.9 milionë euro e cila ka për synim investimet në Telekom konform trendëve. Istrefi ka treguar se nga viti 2009 e deri në vitin 2017 Telekomit ka lëndë nëpër gjykata që janë trajtuar për borxhe, ku vlera e tyre arrin deri në 13.5 milionë euro

kemi sistem të mirëmbajtjes dhe si pasojë e kësaj 120 mijë klientë janë larguar nga rrjetet tona. Sot ne jemi duke kërkuar mundësi t'i përdorim mekanizmat e shtetit që ato para që i kanë përgjegjësi ndaj Telekomit të kthehen në Telekom", ka pohuar Istrefi. Ai ka shtuar se Telekomit i ka alarmuar edhe institucionet e vendit që nëse nuk arrihet kontrata për sistemin e mirëmbajtjes, e cila kushton 6.5 milionë euro atëherë do të ketë rrezik të bien të gjitha shërbimet. "Duke e parë gjendjen e vështirë që është momentalisht ne i kemi alarmuar institucionet tona që ka mundësi që të bien të gjitha shërbimet si pasojë e mospasjes së kontratës të sistemit të mirëmbajtjes e cila kushton 6.5 milionë euro", ka bërë me dije kryeshefi ekzekutiv i Telekomit, Bedri Istrefi.

Ai ka kërkuar mbështetje institucionale për një garanci në vlerë prej 6.9 milionë eurosh. "Kërkojmë nga qeveria që të jetë garantuese për një garanci bankare në vlerë 6.9 milionë euro në mënyrë që të kemi

mundësi të investojmë dhe të jemi konform trendëve", ka thënë ai.

Istrefi ka shprehur gatishmëri që në çdo kohë të jetë në dispozicion të dhënies së informatave rreth proceseve në këtë ndërmarrje si për OJQ-të ashtu edhe për palët e interesuara. Sipas tij, nga ngecja e investimeve kapitale Telekomit ka humbur 6 milionë euro. "Prej vitit 2009 e deri në vitin 2017 ne kemi lëndë nëpër gjykata që janë trajtuar për borxhe. Vlera e tyre arrin deri në 13.5 milionë euro", është shprehur ai.

Ndërkaq duke folur rreth dilemave të ngritura për kompaninë "Artillery One", Istrefi ka thënë se është nënshkruar marrëveshje me këtë kompani, por jo për çështjet në dokumentet konfidenciale. Ai ka theksuar se "Artillery One" nuk ka qasje në financat e Telekomit.

Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit, Bedri Istrefi, ka bërë me dije se do të reduktojë edhe shpenzimet në marketing. Ndërsa kryetarja e Bordit të Telekomit, Besa Shatri-Berisha, ka theksuar

se kjo ndërmarrje ka nevojë për financim. "Telekomit është në rënie dhe investime nuk ka. Probleme kyçe janë edhe mbyllja e borxhit me Z-Mobile, kalimi në kodin 383 dhe mbyllja e borxheve të tjera", ka thënë ajo. Besa-Shatri ka pohuar se kontratat e Telekomit me operatorët e jashtëm, menaxhmenti dhe bordi aktual nuk ka mundësi t'i shkëpusë pasi që janë në pamundësi të shkëputjes.

Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Telekomit, Lahi Balaj, ka thënë se dëmet që janë shkaktuar në këtë ndërmarrje datojnë që nga viti 2018 dhe janë të mëdha. Kulmi i shkatërrimit, sipas tij, ka filluar në momentin që menaxhmenti i Telekomit ka filluar të lidhet me politikën. Sa iu përket deklaratave se Telekomit është afër falimentimit, ai ka thënë se deklaratat e tilla janë të papranueshme dhe po dëmtojnë reputacionin e Telekomit. "Nëse falimenton Telekomit do të falimentojë edhe vetë shteti. Prandaj, deklaratat e tilla duhet të ndërpriten", ka thënë Balaj.

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 25 PRILL** - Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Telekomit, Lahi Balaj, kryeshefi ekzekutiv i Telekomit, Bedri Istrefi, dhe kryetarja e bordit të kësaj ndërmarrjeje, Besa Shatri-Berisha, kanë raportuar të enjten në Komisionin Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala. Para anëtarëve të këtij komisioni, kryeshefi ekzekutiv i Telekomit, Bedri Istrefi, ka thënë se si pasojë

gjë e mungesës së kontratës për sistemin e mirëmbajtjes, Telekomit i janë larguar rreth 120 mijë klientë. "Ka një muaj e gjysmë që kam marrë këtë pozitë, por jam përmbytur dhjetë vjet brenda Telekomit dhe kam qenë i njohur për sfidat në këtë ndërmarrje. Nuk është që nuk ka mundësi të krijohet një stabilitet në Telekom. Në momentin që kam marrë pozitën e kryeshefit të Telekomit kam thirrur menaxhmentin për të krijuar mundësi dhe për të sjellë një stabilitet aty. Ne ka kohë që nuk

## Brenda 24 orëve mblidhen mbi 2 000 nënshkrime për rritjen e pagës minimale

**PRISHTINË, 25 PRILL (ER)** - Zyrtarë të Partisë Socialdemokrate (PSD) ka bërë me dije se brenda 24 orëve peticionin online për rritjen e pagës minimale e kanë nënshkruar mbi 2 000

qytetarë. Në një konferencë për medie, deputeti Frashër Krasniqi dhe zëdhënësja e PSD-së, Natyra Kuçi, i kanë bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që ta marrë vendimin sa më parë për rritjen e pagës

minimale. Kuçi dhe Krasniqi kanë ftuar qytetarët të vazhdojnë ta nënshkruajnë këtë peticion, duke e quajtur këtë formë për rritjen e presionit tek ekzekutive që të ndërmarrin hapa sa më parë.



# Bizneset adresojnë problemet që dalin nga ligji i ri për tregtinë

**EPOKA  
ERE****Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 25 PRILL - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka organizuar tryezë diskutimi rreth ndikimit dhe implikimeve të reja që dalin nga Ligji për tregtinë për sektorin privat në vend.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, e vlerësoi ligjin si të rëndësishëm, por bëri thirrje për shmangie të rregullimit të tepërt, i cili do t'i cenonte raportet ndërbiznesore, por edhe do të vështirësonte të bërit biznes. Ai ka thënë se është

qëndrim i Odës Amerikane se rregullimi i tepërt do ta ngufaste operimin e bizneseve dhe do të ishte në kundërshtim me orientimin e vendit për një ekonomi të tregut të lirë.

Këshilltarja në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Mrika Selimaj, ka thënë se Ligji për tregti parasheh një numër të risive të cilat synojnë në rregullimin e përgjithshëm të tregut në vend, duke thënë se ky ligj anon më shumë nga aspekti administrativ. Selimaj ka theksuar se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë synon t'i bëjë modifikimet e nevojshme në mënyrë

që ky ligj të jetë i implementueshëm dhe se reformat janë më se të nevojshme për ta rregulluar këtë sektor. Ajo ka inkurajuar bizneset e prarishme t'i paraqesin rekomandimet dhe komentet e tyre në lidhje me formulimin e këtij ligji i cili do të ndikojë në veprimtarinë e tyre biznesore.

Kryesuesi i Komitetit të Tregtisë dhe Doganës të Odës Amerikane dhe pronari i "Delfin Ltd", Avni Krasniqi, ka thënë se mungesa e përfshirjes së sektorit privat në formulimin e ligjeve të cilat afektojnë sektorin e tregtisë me pakicë, por

edhe sektorëve të tjerë në përgjithësi po ndikon në zbatueshmëri të duhur të ligjit në vend.

Krasniqi ka shtuar se duke qenë se sektori privat afektohet më së shumti nga specifikat dhe risitë e reja nga ky ligj, bizneset kanë ndrojtje që zbatueshmëria e këtij ligji do të hasë në vështirësi e cila do të rezultojë në parregullsi në treg. Ai ka kërkuar që bizneset të jenë pjesë e pandashme e këtij procesi në dhënien e rekomandimeve për të adresuar çështje të cilat do të paraqitnin barrë për sektorin privat.

Pronari i kompanisë "Proex", Ylber Kuraja, ka theksuar se sektori i tregtisë me pakicë në Kosovë është sektori kryesor i mbushjes së arkave të shtetit, andaj përfshirja e këtij sektori në modifikimin e Ligjit për tregti është e domosdoshme. Ai ka theksuar se mungesa e fiskalizimit të plotë të dyqaneve, mes të tjerash, reflekton në zbatueshmëri jo të plotë të ligjeve aktuale, duke shtuar se përfshirja më e madhe e bizneseve në procesin e draftimit të ligjeve do të mundësonte një adresim më të duhur të çështjeve të cilat afektojnë sektorin privat.




## Kosova anëtarësohet në Unionin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës

PRISHTINË, 25 PRILL (ER) - Republika e Kosovës është bërë anëtare e Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Në komunikatën zyrtare që ka publikuar IUCN-ja është thënë se Kosova u bashkua zyrtarisht në Unionin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës, duke hyrë në një forum neutral në të cilin qeveritë, OJQ-të, shkencëtarët, bizneset, komunitetet lokale dhe të tjerët formojnë dhe zbatojnë zgjidhjet për sfidat mjedisore së bashku. "IUCN shpreh mirëseardhjen e saj të ngrohtë për Republikën e Kosovës si shteti anëtar më i ri në unionin tonë. Ne besojmë se kjo do të na mundësojë të forcojmë më tej praninë dhe

punën e IUCN-së në Kosovë, e cila shtrihet në një nga rajonet më të pasura në Evropë në aspektin e biodiversitetit dhe vlerave natyrore. Shpresojmë se do të angazhohemi së bashku me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ekspertët, komunitetet dhe shoqërinë civile për arritjen e qeverisjes më të mirë në menaxhimin e burimeve natyrore", është thënë deklarata e drejtoreshës së përgjithshme të IUCN-së, Inger Andersen.

IUCN-ja është e vetmja organizatë mjedisore që ka statusin zyrtar si vëzhguese në Kombet e Bashkuara dhe ka 1 300 anëtarë nga mbi 170 shtete. Anëtarësimi i Republikës së Kosovës në



këtë organizatë i sjellë përfitime të shumta MMPH-së dhe në përgjithësi shtetit të Kosovës. Për këtë anëtarësim të Kosovës, ministri i Mjedisit

dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka falënderuar Ministrinë e Punëve të Jashtme, në veçanti zëvendëskryeministrin dhe


ministrin e Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, për mbështetjen në këtë proces, si dhe grupin punues në kuadër të MMPH-së.

## Kërkohet mbështetje financiare për OJQ-të në Mitrovicë

**MITROVICË, 25 PRILL (ER)** - Drejtoria e Administratës, respektivisht Njësia për të Drejtat e Njeriut në Komunën e Mitrovicës, ka bërë thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare dhe financimin e projekteve për të gjitha organizatat joqeveritare të cilat veprojnë në Komunën e Mitrovicës, e të cilat merren me

mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, promovimin dhe avancimin e femrave në vendimarrje, barazi gjinore dhe të drejtat e komuniteteve. Koordinator i Njesisë për të Drejtat e Njeriut, Fitim Rama, ka thënë se Komuna e Mitrovicës sipas mundësive buxhetore është duke i

mbështetur financiarisht OJQ-të, të cilat përmes aktiviteteve të tyre synojnë zhvillimin dhe avancimin e femrave në vendimarrje, ngritjen e njohurive mbi të drejtat e njeriut si dhe përkrahjen e personave me aftësi të kufizuara. Ai ka shtuar se shumica e përgjithshme e mbështetjes financiare për këtë thirrje është 15 500 euro.



## Komuna e Malishevës dhe UNDP-ja nënshkruajnë marrëveshje për projekte të përbashkëta



**MALISHEVË, 25 PRILL (ER)** - Komuna e Malishevës ka nënshkruar të enjten një memorandum mirëkuptimi me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) për realizimin e projekteve me interes të përbashkët. Kjo marrëveshje është nënshkruar në mes të kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begajt dhe përfaqësueses së përhershme të UNDP në Kosovë, Alessandra Roccasalvo. Bazuar

në këtë marrëveshje, të dyja palët kanë për qëllim të sigurojnë një kornizë të bashkëpunimit dhe të lehtësojnë këtë bashkëpunim në fushat me interes të përbashkët. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, në qytetin e Malishevës është duke u realizuar projekti i rregullimit të shtratit të përroskës në qytet, me qëllim të parandalimit të përmytjeve që zakonisht shkakton kjo përroskë në kohën e shirave.

## Muharremaj thotë se do ta vazhdojë bashkëpunimin me bizneset e Suharekës

**Suharekë, 25 prill (ER)** - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka pritur në takim kryetarin e Qendrës së Biznesit në këtë komunë, Gani Sallauka. Pas takimit, kryetari Muharremaj ka thënë se është i

interesuar ta vazhdojë bashkëpunimin me bizneset e Komunës së Suharekës në funksion të hapjes së vendeve të reja të punës. "Pata kënaqësinë ta takoj sot kryetarin e Qendrës së Biznesit në Suharekë, Gani

Sallauka dhe anëtarët e tjerë të bordit. Jam i interesuar të bashkëpunoj edhe më tutje që bizneset tona të kenë kushte sa më të favorshme për zhvillim dhe shtim të vendeve të reja të punës", ka thënë Muharremaj.



## Kryetari Latifi mban takim me fermerët e Rahovecit

**RAHOVEC, 25 PRILL (ER)** - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka bërë me dije se të enjten është mbajtur diskutim me fermerët e Rahovecit me të cilët ka bashkëbiseduar me ekspertët e BE-së dhe të Qeverisë së Kosovës për plasimin e prodhimeve të bujqve në tregun e shteteve të BE-së, sigurinë në ushqim, mbrojtjen e prodhimeve vendore dhe tema të ngjashme. "Konstatuam se Rahoveci ka kapacitete dhe produkte cilësore për eksport dhe se do të

angazhohemi bashkërisht që të punohet për rritje të eksportit, rrjedhimisht prodhimit", ka thënë ai.

Latifi ka shtuar se në thirrjen që është e hapur në sektorin e bujqësisë nga Komisioni Evropian shpreson të ketë sa më shumë dobi për komunën që drejton. "Kur dihet se në të kaluarën disa kompani nga Rahoveci kanë fituar grante, mundësia për përfitim nga bujqit është shumë e mirë", ka deklaruar kryetari Latifi.

## Nxënësit e Kamenicës informohen për të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e tyre

**KAMENICË, 25 PRILL (ER)** - Zyra Regionale e Institutit të Avokatit të Popullit (IAP) në bashkëpunim me Njësia Komonale për të Drejtat e Njeriut (NJKDNJ) kanë mbajtur ligjëratën me nxënësit e klasave të VIII-ta dhe IX-ta në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët "Xhavit Ahmeti" në Hodonoc me temën "Të drejtat e njeriut, me theks të veçantë të drejtat dhe detyrat e fëmijëve".

Zyrtari ligjor pranë Zyrës Regjionale të IAP-it, Shemsedin Mustafa, u ka ligjëruar nxënësit për rolin dhe mandatin e Avokatit të Popullit si dhe për të drejtat e njeriut në përgjithësi. Ndërsa koordinatoresha e NJKDNJ-së, Nazmije Demolli-Kastrati, ka thënë se fëmijët përkatësisht nxënësit kanë të drejta dhe detyra të shumta. Po ashtu, ajo ka folur para nxënësit për rolin dhe funk-

sionimin e Zyrës për të Drejtat e Njeriut në komunën e Kamenicës. Në anën tjetër, drejtoresha e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët "Xhavit Ahmeti", Sofije Krasniqi, ka falënderuar ligjëruesit duke shprehur se ligjëratat e tilla të mbahen në vazhdimësi pasi, sipas saj, nxënësit kanë nevojë të marrin njohuri të reja lidhur me të drejtat dhe detyrat që i kanë.



# Kosova, shteti i dytë i kombit shqiptar



Xhavit HALITI

Po mbushen 20 vjet nga çlirimi prej sundimit serb dhe janë bërë 11 vjet nga shpallja dhe njohja ndërkombëtare e Kosovës shtet, nga më se gjysma e anëtarëve të OKB-së. Por, me gjithë këto arritje, vazhdojnë të gjallojnë e zhurmohen mes nesh, në grupimet shoqërore e në politikë, dy mentalitete:

- Së pari, Republika e Kosovës u krijua për t'i paraprirë dhe për të realizuar dhe njohur ndërkombëtarisht bashkimin e Kosovës me Shqipërinë;

- Së dyti, zgjidhjen e raportit kuptimor e funksional mes shtetit dhe kombit. Objektivi themelor i këtij mentaliteti është dilema "kombi e bën shtetin apo shteti e bën kombin".

Idetë, përvoja dhe historia evropiane dhe botërore ende nuk japin një përgjigje përm-

byllëse për përparësinë në raportet komb-shtet; kombi krijoi shtetin apo e kundërta. Në shqiptarët, qysh në shekullin 19-të, kemi aspiruar, jemi përpjekur e kemi luftuar, si dhe kemi bërë prezent të "Fuqitë e Mëdha" dëshirën dhe synimin për të krijuar komb dhe shtetin kombëtar. Synimi, dëshira dhe përpjekjet e gjithanshme të shqiptarëve krijuan shtetin. Pra, ne, të gjithë shqiptarët, që jetojmë në trojet tona etnike në Ballkan krijuam shtetin, Shqipërinë, që jo për fajin tonë, nuk përfshiu brenda kufijve politikë gjysmën e kombit dhe të territoreve shqiptare. Ky shtet edhe pse i gjymtuar rëndë gjeografikisht e politikisht shërbeu si kolonë mbajtëse e referencë për gjithë kombin. Në emër të tij jemi prezantuar si shqiptarë në ish -Jugosllavi, por edhe ku kemi emigruar. Ekzistenca e Shqipërisë, referimi tek ajo, te simbolet shtetërore të saj (flamuri, himni), ka pasur ndikimin e vet të ndjeshëm në statuset politike e kushtetuese të Kosovës në ish -Jugosllavi. Nga pjesë e Serbisë u bë krahinë autonome, e në mes të viteve '70-të u njohëm si subjekt i barasvlefshëm

kushtetues me republikat e tjera. Kuptohet, kjo u arrit me sakrificat dhe luftën tonë në emër dhe nën frymëzimin kombëtar që, natyrshëm, edhe frymëzoheshin e mbështeteshin edhe nga Shqipëria.

Kombi ynë, pas luftërash dhe përfundimesh jo të drejta ndërkombëtare, sot njihet dhe mund të prezantohet kudo në Botë me emrin e vet kombëtar, nën siglën e dy shteteve. Në emër të shtetit, shqiptarët aktualisht kanë dy ulëse në Asamblenë

Parlamentare të KE-së, në UEFA dhe FIFA, në Bankën Botërore, në FMN, si dhe në bashkësinë e shteteve evropiane dhe në bashkësinë e shteteve të Ballkanit Perëndimor. Tashmë Kosova është shtet, subjekt i bashkësisë evropiane e botërore, dhe si shtet i ri, na takon e drejta për anëtarësim në OKB, NATO dhe në BE. Të gjitha këto i bëjmë në emër të shtetit, por jo të kombit.

Fillim zgjidhjet e dy çështjeve të parashtruara janë të qarta dhe mjaftueshëm të arsyeshme. Objektivi i luftës tonë ishte shkëputja nga Serbia dhe bashkimi me Republikën e

Shqipërisë. Në arritje të këtij objektivi të luftës, ishim nxitës, mbështetës dhe bashkësakrifikues me aleatin tonë të madh NATO-n. Fituam dhe si fitimtarë bashkërisht vendosëm edhe rregullat; pavarësi të garantuar për Kosovën, njohje ndërkombëtare për të, dhe strukturimi e funksionimi si shtet në raportet rajonale e ndërkombëtare. Kemi festuar 11-vjetorin e shpalljes së pavarësisë dhe jemi në prag të 20-vjetorit të çlirimit nga Serbia, por ende jemi në përballje me dilemën: një shtet unifikon kombin, ndërsa dy shtete të njëjtit komb e ndajnë atë. Në përpjekje për t'i dhënë një zgjidhje dilemës së më sipërme mendoj se janë edhe veprimet e 5-6 viteve të fundit të qeverive në Prishtinë dhe Tiranë për organizimin e mbledhjeve të përbashkëta, për hapje kufiri, njësim doganash, marrëveshje tregtare e veprimesh në rrafshin e arsimit e kulturës.

Me çlirimin dhe pavarësinë si shtet u njohëm dhe fituam të drejtën që në mbarë botën të kemi një emër, një simbol dhe një vend përfaqësues, pa fshehur përkatësinë kombëtare.

Prirja dhe përpjekjet e ndryshme për bashkim, të dy shteteve në emër të kombit është më tepër politike, shpirtërore se sa reale. Në kushtet aktuale gjeo-politike ekzistenca e dy shteteve, e dy ulëseve, e dy zërave në forumet ndërkombëtare është një përparësi e kombit tonë të përbashkët.

Ka dy shekuj që Evropa dhe më gjerë na njohin si komb. Por fqinjët tanë që krijuan shtete para nesh, janë përpjekur historikisht të na ç'bëjnë, të na përçajnë, të na asimilojnë, të na dëbojnë nga trojet tona dhe të na lënë pa atdhe. Dhe kur dështuan në këtë synim, amplifikuan idenë e "paaftësisë" së shqiptarëve për të bërë shtet. Por, krijimi dhe funksionimi i dy shteteve tona në Ballkan dëshmon të kundërtën. Na është dhënë mundësia të demostrojmë botërisht aftësinë kombëtare për të bërë shtete dhe përmes fuqizimit e konsolidimit të tyre, të begatojmë e të prosperojmë mbarë kombin shqiptar në trojet etnike e në diasporë.

(Autori është nënkryetar i Kuvendit të Kosovës)

## Ministria e Integrimit Evropian: Të tejkalohen sfidat për të drejtat pronësore



PRISHTINË, 25 PRILL (ER) - Në takim për Strategjinë Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, ku morën pjesë anëtarët për hartimin e kësaj strategjie, sekretari i përhershëm i Ministrisë së Integrimit Evropian, Kushtrim Cukaj, ka mbajtur një ekspozitë, me ç'rast ka vlerësuar se rregullimi i çështjeve pronësore-juridike përbën

element shumë të rëndësishëm për zhvillimin e fushëveprimit të së drejtës civile në Kosovë.

Cukaj ka thënë se rëndësi të veçantë për sistemin juridik të Republikës së Kosovës luan Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, e cila garanton të drejtën për të zotëruar, të përdorë, të disponojë ose të lërë trashëgimi pronën e tij apo të saj

të fituar në mënyrë të ligjshme. "E drejta e pronës dhe mbrojtja e saj përbën ndër parimet kryesore kushtetuese. Po ashtu, mbrojtja e pronës dhe ndalimi i privimit në mënyrë arbitrare nga prona janë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës", ka thënë sekretari Cukaj, duke shtuar se fuqizimi dhe zbatimi në praktikë i së drejtës pronësore në

Kosovë është shoqëruar me sfida. "Qëllimi i Strategjisë Kombëtare për të Drejtat Pronësore, i ndërlidhur edhe së fundmi me përmblidhjen e Kodit Civil, përbën një hap shumë të rëndësishëm në përmirësimin, qartësimin dhe ofrimin e sigurisë juridike për zbatimin e së drejtës pronësore në praktikë", ka deklaruar sekre-

tari i përhershëm i MIE-së, Kushtrim Cukaj. Ai ka shtuar se synimi i Strategjisë Kombëtare për të Drejtat Pronësore së bashku me dispozitat referuese të përmblidhura në Kodin Civil janë garanci për fuqizimin e kësaj të drejte dhe implementimin e saj në praktikë për të gjithë qytetarët pa dallim, veçanërisht grave dhe vajzave.

**E jashtëzakonshme**

# Zogu që vrau pronarin do të dalë në ankand

Për shumicën e njerëzve një breshkë ose një peshk me ngjyra të ndezura konsiderohet një kafshë mjaft ekzotike. Por në Florida, një zog gjigant me kokë blu, që vrau pronarin e tij të fundit, pritet që këtë të shtunë të dalë në ankand. Marvin Hajos ishte pronar i një grupi të madh kafshësh, nga papagalli, tek lemurët, në shtëpinë e tij në Gainesville. Më 12 prill,



75-vjeçari ra në zonën ku qëndronin zogjtë e llojit kaspar dhe u sulmua nga të paktën një nga zogjtë e tij gjigantë, ku vdiq nga lëndimet.

**BARSOLETA E DITËS**



**Djali:**  
- Babi, a është e vërtetë se në disa vende burrat nuk i njohin gratë para martesës?  
**Babai:**  
- Ajo ndodh në të gjithë planetin, bir. Pasi martohesh e merr vesh se kush është gruaja.



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Në ora 16:00

## “HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World” 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.  
Regjia: Dean DeBlois



**FOTO E DITES**



Një kor i marinës kineze performon gjatë një koncerti me grupet ushtarake kineze dhe të huaja në Qingdao. /AP/

Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)

## “THE KID WHO WOULD BE KING”,

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.

Regjia: Joe Cornish



Në ora 20:00

## “CAPTAIN MARVEL” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.

Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck




Në ora 22:00

## “U S”

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon

Regjia: Academy Award@-winning visionary Jordan Peele




**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

**E rrallë**

# Milioni 22-vjeçar braktis jetën e luksit për të fjetur në rrugë

Një 22-vjeçar milioner, Kieren Hamilton, i cili bën një jetë mes luksit, makinave super të shtrenjta dhe pushimeve ekzotike, ka preferuar që për disa ditë të bëjë një jetë si i pastrehë. Ai kaloi tre net duke fjetur në rrugë, poshtë një qendre tregtare në Londër për t'u bërë



pjesë e dokumentarit "Kur të pasurit bëjnë një jetë si të pastrehë". Kieren ka plotë 81 400 ndjekës në "Instagram" dhe jeton në një shtëpi luksoze në Manchester.

 <p><b>DASHI</b> Duhet të filloni ta rigjeneroni trupin dhe mendjen. E ku ka më mirë se ecje të gjata në ajër të pastër dhe kjo është pikërisht stina e duhur.</p>	 <p><b>DEMI</b> Një ditë e zhurmshme në planin e punës ku po vraponi për çdo gjë dhe për çdo detyrë. Mjaft të angazhuar, ndërkohë që një surprizë po përgatitni për partnerin.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Sot dita është e mbushur me ngjarje të mëdha e të vogla, por që të gjitha mbartin një ndjenjë afektive kundrejt jush që do t'ju përkëdhelë.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Nuk po arrini dot t'i menaxhoni personat e rinj në jetën tuaj. Në shumë raste do të keqkuptoni atë që do t'ju thonë dhe do të keni pakënaqësi.</p>	 <p><b>LUANI</b> Megjithëse personat përreth jush ndiejnë shqetësime fizike këtë periudhë, falë regjimit tuaj ditor ju jeni në formë mjaft të mirë fizike.</p>	 <p><b>VIRGJËRESHA</b> Disa diskutime që kanë shumë kohë që janë hapur në familjen tuaj, më në fund do të arrijnë të finalizohen më së miri.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Dëshira për t'u socializuar sot ju sjell njohje të reja në çdo fushë të jetës. Disa prej tyre janë ato që po prisnit prej kohësh.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Do të keni mundësi të vizitoni një nga ato vende që ka qenë në dëshirat tuaja që herët. Gjithçka do t'ju duket më mirë sesa që e kishit menduar.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Sot do të shihni vetëm anën e mirë në çdo situatë dhe këtë gjë do të arrini ta përçoni edhe te të tjerët. Ditë e këndshme dhe me humor.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Disa çështje praktike që i kishit lënë pas dore sot do të arrini t'i zgjidhni falë ndihmës që do t'ju japë një i njohuri juaj i vjetër.</p>	 <p><b>UJORI</b> Do të keni fat në dashuri këtë periudhë falë pranisë së Venusit në shenjën tuaj. Nuk do ta kuptoni që në fillim këtë gjë.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Lëvizja e planetëve sot do t'ju sjellë të reja të këndshme dhe do t'ju japë mundësi për ndryshime të mira në financat tuaja.</p>

## Hailey Bieber flet për betejën me ankthin



**H**ailey Bieber ka folur për betejën e saj me ankthin. Modeluesja 22-vjeçare thotë se ajo luftoi me ankthin për një vit e gjysmë deri në atë pikë saqë s'mund të flinte, por ajo tani po ndihet shumë më mirë. "Nuk duhet të sundoresh nga mendimet e tua. Ju mund ta merrni kontrollin.


Duhet ta pyesni veten 'a është kjo e vërtetë?', përkundër asaj çka mendoni", ka pohuar gruaja e Justin Bieberit për "Glamour". Ajo ka treguar se ka gjetur ndihmë përmes 'terapisë, meditimit dhe besimit' dhe vlerëson se njerëzit tani janë më të hapur rreth kësaj sesa në të kaluarën.

## Vdes aktori i famshëm Ken Kercheval



**A**ktori i famshëm Ken Kercheval ka vdekur në moshën 83-vjeçare. Sipas "People", Kercheval ka vdekur të

dielën, teksa arsyeja e vdekjes ende nuk dihet. Kercheval është i njohur për rolin e tij Cliff Barnes në shoun "Dallas".



## Jennifer Garner tregon çfarë komplimente merr nga fansat

**J**ennifer Garner ka treguar se çfarë i thonë asaj fansat më së shpeshti kur e takojnë atë. "Ata më thonë se unë jam më e bukur në jetën reale sesa në televizion. Këtë e dëgjoj më së shpeshti", ka

treguar aktorja 47-vjeçare. "Ata duan të bisedojnë me mua sepse ju duket sikur jemi rritur bashkë", ka thënë Garneri, e cila është ndarë nga burri i saj Ben Affleck, me të cilin ka tre fëmijë.

## Britney Spears humb pesë kilogramë nga stresi



**B**ritney Spears doli në qytet pas lajmeve se ajo ishte në një qendër të shëndetit mendor në fillim të këtij muaji. Të mërkurën këngëtarja 37-vjeçare hyri në "Instagram" për t'u treguar ndjekësve

se ajo po kujdesej për shëndetin e vet mendor duke u stërvitur. Ajo ka pranuar se ka humbur peshë nga stresi. "Kush do ta mendonte që nga stresi do t'i humbisja pesë kilogramë", ka thënë Britney Spears.

# NUK I GJEJ ILAÇ PANDERSHMËRISË SË PUSHTETARËVE (2)

## HISTORINË MË TË MIRË DERI SOT PËR KOSOVËN E SHKROI NJË I HUAJ

**Intervistoi: B. Armagedoni**

*Jakup Krasniqi, në një promovim libri në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, i keni sugjeruar, pak a shumë, kështu: Jakup, tashmë jeni pensionuar dhe nuk keni ndonjë detyrë në institucione. Tërhiquni nga politika dhe merrni vetëm me shkrime. Tashmë jeni pensionuar edhe ju, Adem. Çfarë do t'i thoshit sot Jakup Krasniqi po t'ju sugjeronte njëjtë?*

**GASHI:** Po, e kujtuake saktë! Z. Jakup Krasniqi sa kishte mbyllur një "betejë" me partinë ku ishte bashkëthemelues, po i hynte një të reje, gjithnjë si bashkëthemelues, me një terren po aq të rrëshqitshëm. Platforma e tij politike e shtruar në librat autorialë ishte dhe është në diskrepancë të dukshme me subjektin politik. Ky fakt e bën të dallueshëm pozicionin e tij me timin.

*Për veprat që keni botuar keni marrë edhe disa çmime, jo pak të rëndësishme. Çmimet që keni marrë, ju kanë bërë poet më të mirë, ju kanë motivuar të botoni libra të tjerë?*

**GASHI:** Pa diskutim, të marrësh çmim për një vepër letrare ndihesh i vlerësuar. Në një periudhë të hershme kur s'kisha botuar libër çmimet ishin edhe motivuese. Nganjëherë mendoj se po të mos ishin konkurset anonime, me shifër në vend të autorësisë, në revista dhe gazeta s'do të më njihje njeri për shkrimtar sot. Kam një kuotë rekorde prej rreth 50 çmimeve, në periud-

hën 1977-1988. Tashti edhe kjo puna e çmimeve letrare, do të thosha, është banalizuar që kur dolën këto "juritë profesionale". Keni dëgjuar ju për to ku defilon lloj-lloj anonimusi?

*Si nuk kam dëgjuar. I kam në nishan sa herë që përbëhen, sa herë që mblidhen në kafene, në qebaptore, në çajtoje dhe sa herë që gjykojnë për libra dhe për shoqëri.*

**GASHI:** E pra...

*Zhvillimet e letërsisë shqipe dhe të huaj i përcillni. Çfarë po krijohet sot më shumë dhe çfarë do të duhej të krijohet?*

**GASHI:** Nuk është se parapëlqej të jap këshilla e etiketa, po konstatimet më vijnë vetiu. Më shumë shkruhet pseudopoezia, më pak poezia e mirë dhe ende më pak tregimi e romani i mirë. Rrjetet sociale, forumet e portalet virtuale i kanë ofruar sekujt mundësinë e publikimit të shkrimeve të veta dhe iluzionin e kënaqësisë. E keni parë se me ç'krekosje deklarohen disa që kanë botuar nga një libërth vjershash: Ne poetët, në shkrimtarët! Madje shkelin edhe rregullën drejtshkrimore. Nuk thonë ne poeteshat (ç'është kjo prapashetë si sekretarësh), po "ne poetet"! Përkundër kësaj dalldie, nuk ka një sistem ekuilibrimi e seleksionimi. Doemos që edhe ky haraç duhet t'i paguhet periudhës së tranzicionit shoqëror, çakordimit të sistemit të vlerave, moskonsolidimit institucional e të tjera.

*Jetoni në kryeqytetin e Kosovës, në të cilin, më shumë*

*se në cilindo qytet të saj, promovohet disi kultura dhe, po ashtu, disi arsimit dhe shkencë. Si ju duket veprimtaria kulturore, arsimore dhe shkencore që zhvillohet përreth jush, në seminare ndërkombëtare që organizojnë fakultetet, në konferenca shkencore të instituteve dhe të akademive?*

**GASHI:** E di se për muzikën është "gjetur" dhe "adoptuar" një emërtim krejt i pakuptimtë, por shumë ilustrues, tallava. Disa nga veprimtaritë shkencore e kulturore, pavarësisht prej faktit paradoksal, kur kanë ruajtur disa forma të traditës së gjatë, kanë dhënë rezultate; kur kanë bërë provën e transformimeve pa përgatitje të nevojshme profesionale e disiplinë shkencore, kanë degjeneruar në surrogate. Merreni sistemin arsimor. Me vite "bombardohemi" me nocionet reforma, si Evropa, Sistem i Bolonjës dhe del PISA e na e dëshmon nivelin e skajshëm të mosdijes.

Ndoshta pikiata më e tmerrshme e degradimit shënohet mu mbi kupolën e ASHAK-ut. Aty madje janë kaq të sheshta mbrapshtitë sa s'ka pse lodhët të argumentojë gjë njeriu. Lër mënjane shkencën e kulturën aty, pa shih dhe moralin. Një kryetar i rizgjedhur me precedent vjedhjeje të buxhetit të shtetit. Lëre se u bëmë gaz i botës para të tjerëve, po ç'do t'u themi nesër fëmijëve tanë? Në këtë plan nuk ka alibi shfajësimi asnjë instancë shtetërore e shoqërore, asnjë formacion sado i thjeshtë kulturor, madje asnjë individ me dy fije mend.

*Një tekst për historinë e letërsisë shqiptare, prej fillimit të saj e deri më tash, ende na mungon. Disa histori letërsie, për disa periudha të letërsisë sonë, nuk është që s'janë shkruar. Kur duhet të shkruhet një histori letërsie që mos të shkruhet edhe një tjetër më për nja pesëdhjetë vjet?*

**GASHI:** Po i pamë titujt e gradat shkencore, universitetet, kolegjet

e institutet kjo punë do të dukej e tejkualuar tashmë. Edhe kjo është pasqyrë degradimi. Pas Luftës së Dytë Botërore për shumë dekada jemi mjaftuar me "Historinë e letërsisë" të Shuteriqit. Pastaj një si diçka. Pastaj një "Histori e Letërsisë Shqipe, Romantizmi I, II, III" e akademik Qosjes. Plasja si s'na vjen. Historinë më të mirë deri sot për Kosovën e bëri një i huaj (Noel Malkolm). Historinë më të mirë të Letërsisë shqipe, s'rish një i huaj (Robert Elsie). Ku na mbeti ajo krekosja jonë dhe mburrja deri në marrëzi? Kur pra? Kur do të shkruhet diçka e tillë? Me këta njerëz të sotëm jo. Po i rikthehemi s'rish shpresës së horizontit të pritjes.

*Cila periudhë e letërsisë shqipe, cilët shkrimtarë dhe cilat vepra ju kanë lënë mbresa më të mëdha?*

**GASHI:** Mund t'ju duket mbase e çuditshme përgjigjja ime. Periudha e letërsisë së viteve të tridhjeta të shekullit të kaluar. Duket e paperceptueshme, në kulmin e degradimit shoqëror, politik e shpirtëror; në kulmin e

krizës më të madhe sociale e politike të shkëlqejnë në qiellin e botës letrare shqiptare krijues si Noli, Migjeni e Poradeci; Kuteli, Koliqi e Merxhani.

*Letërsia e huaj po vjen në shqipe shpejt, kryesisht nga botuesit e Shqipërisë, ndërkaq letërsia shqipe po depërton jashtë shumë pak. Është letërsi e varfër tematikisht dhe stilistikisht, apo çfarë po ndodh? Mund të na përmendi shkaqet?*

**GASHI:** Jo, e mendoj të kundërtën. Në planin stilistik e tematik dhe përgjithësisht në planin artistik letërsia shqipe nuk ka pse të ndihet inferiore, së paku për aq sa lexojmë e dimë të vlerësojmë të tjerët që na vijnë në shqip. Edhe ato pak përkthime që janë bërë, sidomos të autorëve nga Kosova, janë bërë mbi bazën e njohjes dhe të kontakteve personale. Këtu nis pika e rënies. Janë përkthyer libra që as këtu nuk thonë gjë e lëre më për lexuesin e huaj. Shihni ç'kërdi është bërë me përkthimet në rumanisht. Nuk janë dhjeta po qindra. Emra djemsh e vajzash e grash e





vejanash e vejushash që as dëgjuar i ka lexuesi i Prishtinës. O ç'ironi! Edhe na përcillen opinione kritikësh rumunë, me të vetmen formulë vlerësimi huazuar nga kodi etik: "Kjo është poezi e sinqertë, e vërtetë", "Ky është një autor i sinqertë dhe transparent"... e të tjera të ngjashme. E pra duhet ngritur një formacion përzgjedhësish ku me debat të hapur të seleksionohen veprat më të arrira, për t'ia prezantuar botës në gjuhë të huaja me mbështetje institucionale. Në Shqipëri është bërë diçka e këtillë. Provë dëshmie kemi edhe "Gjeneralin e ushtrisë së vdekur" të Kadaresë që në krye të herës u botua frëngjisht mu në Tiranë.

Anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK-ut) nuk jeni sepse nuk ia keni mësyre asnjëherë, sa di. Megjithatë, i keni parë ata që janë futur brenda saj që, së paku, nja njëzet vjet. Çfarë mund të na thoni për ASHAK-un dhe për

punën e saj?

**GASHI:** Thashë diçka më lart për të. Po m'u kërkua me çdo kusht të shtoj gjë duhet të qëmtoj fjalë të pista nga Fjalori i Shqipes.

*Institucion, po kaq me rëndësi për albanologjinë sa ASHAK-u, është edhe Instituti Albanologjik, i cili shkencën nuk po e zhvillon sikurse e ka zhvilluar para njëzet vjetësh, nën masat e dhunshme serbe. Pse, Adem?*

**GASHI:** Nuk e lë shumë larg Akademisë, megjithatë, që të jem i sinqertë deri në fund, nuk më është e njohur sa duhet puna e Institutit. Nga punimet e disa individëve brenda tij të mbërthen neveria. Nën masat e dhunshme ishte shtysa nga vullneti i brendshëm, nga atdhetaria dhe nga ideali i lirisë. Këto tri motive tashmë janë harxhuar.

*Sigurisht ende i ruani në celular ose në notes numrat e celularëve të miqve tuaj që tashmë kanë ndërruar jetë.*

*Kush prej tyre ju mungon më së shumti?*

**GASHI:** Më ka trishtuar vdekja e Hajdar Salihut, një prozatori të rrallë; më ka ardhur e dhimbshme vdekja e Podrimjes, e Çapriqit; më ka goditur vdekja e Abdullah Konushevcit, Arif Demollit, Ragip Sylajt...

*Përpos kompletit të veprës, çfarë do të botoni tjetër këtë vit?*

**GASHI:** Në fundjavë, në Panairin e Librit në Kukës, paraqiten dy libra të mi, njëri ribotim e tjetri premierë ("Ndeza një qiri" - poezi) nga shtëpia botuese "Adonis", Tiranë - Durrës. Nuk do t'i falja vetes po s'e publikova sivjet edhe "Antologjinë e zezë", të kryer tashmë.

*Po ju jap edhe pak hapësirë, sall për një fjali të shkurtër.*

**GASHI:** Do ta doja të gjatë, sa për katër poezi të pasluftës.

(Fund. Marrë nga numri i pestë i revistës 'Akademia')

## SKAJET E LIRISË

### 1. Ëndrra e parë

*Mureve të holla të tendës së gjumit  
Erdhi lehtë ëndrra e parë në liri  
Trokiti lehtë me lehtësi zogu  
Në pezulin e qiellit të syrit*

*Të gjithë u bëmë nga pak fëmijë*

*Pak si puhi e pak borë e bardhë  
Trokiti ëndrra ndrojtur  
Ndrojtur si dashuria e parë*

*Kujt t'i rrëfëhet ëndrra  
Skajeve të lirisë mungojnë më të dashurit*

*Përtej perdes së ëndrrës  
Me linjë ultravalësh  
Ata na i dërgojnë kujtimet  
Dhe luleplagët*

### 2. Lëvrimi

*Pas dy vjetësh në arën e braktisur  
Nis hullia e parë  
E hollë e përdredhur  
Si një lojë tekanjoze vijash  
Në fletoren e bardhë*

*Dikush paska mbetur gjallë  
Derisa merr farën ara  
Për kallinjtë lazdrakë*

*Në skajet e saj  
Si në skajet e lirisë  
Prehet bujku i vrarë  
Arë e vogël bëhet kontinent  
Për buzëqeshjen e bimës*

*Oë andej na dërgojnë mesazhe të blerta  
Të rënë  
Të rënë ngrihen monument  
Në çdo lëvrin të stinës*

### 3. Rrobat e reja

*Në festat e harruara skajeve të lirisë  
Çdo ditë e zakonshme bëhet ditëfeste  
Me një pikëllim të përkorë  
Çorapëve të grisura*

*Kostumet tona gjeografi e botës  
Romboidë pallatesh në fanella  
Savane të blerta mëngoreve  
E kaktuse xhepave*

*Flokët e pakrehur e flokët e krehura  
Shkundin pluhur shkumbi e baruti  
Mbi peliçe dhelprash*

*Ata që e deshën ditëfestën tonë  
Të ylbortë  
Prehen skajeve të lirisë  
Mbështjellë me savan humusi të zi  
E të përhertë*

### 4. Sytë e hutuar të viçit

*Sytë e hutuar të viçit  
Në perimetrin e zmadhuar të baladës së përbotur  
Askënd nuk bezdisin*

*Janë pjesë e skajeve të lirisë  
Si një letër dashuri me kornizë të djegur*

*Një viç me një kone pranë  
Në dhimbjen tonë paskan hise*

*Duken tërësisht sovranë  
Nga mbretëria e tyre e braktisur  
Para ish-diskotekës së gremisur*

*Në të zezë e syve të tyre  
Si në një ekran të prishur  
Pamje krejt surrealistike*

*Mjaftojnë si shoqërim muzikor  
Vetëm tingujt pitagorianë të yjeve*

Nga "Dorëshkrim i djegur", 2001



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com

**Sport**

QENDRA SPORTIVE  
**"BUJQËSIA"**  
TEL: 045 82 82 82

## Duka mblodhi përfaqësuesit e klubeve, diskuton për ndryshimet në paketën fiskale

TIRANË, 25 PRILL - Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, ka organizuar një mbledhje informuese me përfaqësues të disa klubeve të futbollit në vend rreth ndryshimeve në paketën fiskale dhe Kodin Penal të propozuar pak kohë më parë edhe nga kryeministri i vendit, Edi Rama.

Olsi Rama, përfaqësues i Partizanit, Sinan Idrizi, si administrator i Flamurtarit, Koço Kokëdhima, përfaqësues i Apolonisë, Safet Gjici i Kukësit dhe Edvin Libohova si president i Ligës kanë qenë përballë katër ekspertëve të marrë po nga FSHF-ja, dy prej tyre ligjorë dhe dy financiarë, për të diskutuar ndryshimet.

Temat kryesore lidheshin sigurisht me paketën fiskale.

Administratori i Flamurtarit, Sinan Idrizi, ka propozuar që asetet t'u kalojnë klubeve me vlerë një euro, me kushtin për të mos i ndryshuar



destinacion. Por, një gjë e tillë do të diskutohet nga ekspertët e Ministrisë së Financave, e cila ka shprehur hezitim për heqjen e tatimit për investime në sport duke propozuar uljen e tij.

Edhe sa i përket heqjes së TVSh-së

për investimet në sport vihet re i njëjti hezitim. Ky ishte një nga takimet që do të zhvillohen deri në arritjen e një marrëveshje përfundimtare që do t'i ulë palët rreth muajit qershor së bashku me kryeministrin e vendit.

## Piloti polak dhuron spektakël, ul avionin në pistën e ngushtë

VARSHAVË, 25 PRILL - Piloti i garave ajrore, Lukaz Czepliela, ka arritur të bëjë një ulje fantastike të avionit të tij në pistën historike rreth 200-vjeçare të Sopotit në Poloni, duke i habitur turistët që po shëtisnin në atë moment në bregdet. E veçanta e kësaj platforme qëndron te përmasat e saj pasi është e ngushtë, por është edhe më e gjata në Evropë. Gjerësia e kësaj platforme është 10.5 metra po aq sa edhe avioni që po drejtonte Czepliela.

Piloti Czepliela njihet në këtë disiplinë sportive për precesionin e tij gjatë fluturimeve, por në këtë rast ai duhej të shfaqë një saktësi të madhe në drejtimin e avionit gjatë uljes së tij në një vend kaq të ngushtë.

Një fakt interesant për pilotin e gar-



ave ajrore është se Czepliela kur nuk është në adrenalinën e garimit në lartësi të mëdha, është kapiteni i një avioni pasagjerësh.

Për ta bërë uljen në pistën e Sopotit

ai përdori avionin e llojit Carbon Cub EX2, një avion që favorizon uljet në distanca të shkurtra, duke u përballur edhe me motin me erë gjatë kësaj performance të tij.



## Lukaku ëndërron të luajë në Serinë A

Romelu Lukaku është një prej sulmuesve që pëlqehet shumë nga klubet e Serisë A, me Juventusin e Interin që janë dy ekipet më të interesuara për të. Repreruesi i Belgjikës ka pasur një sezon jo të mirë me Manchester Unitedin dhe mund të ndodhë që të largohet nga "Djajtë e Kuq" gjatë kësaj vere. Në një intervistë për "Sky Sport Italia", Lukaku ka

deklaruar që e ëndërron të luajë një ditë në Serinë A. "Të luaj një ditë në Serinë A do të ishte një ëndërr e madhe për mua. Shpresoj që një ditë të luaj në kampionatin italian, edhe pse për momentin jam i fokusuar vetëm te Manchester Unitedi", ka thënë Lukaku, i cili është pjesë e Unitedit që nga viti 2017 ku u transferua nga Evertoni.

### TREGU I FUTBOLLIT

Më të fundit nga bota e madhe e tregut të futbollit, ku ofertat apo zërat për transferime lojtarësh nuk mungojnë asnjëherë.

#### Milani synon afrimin e Malcomit

Milani po punon ta transferojë në Itali sulmuesin brazilian të Barcelonës, Malcom. Ky i fundit nuk po gjen hapësira te katalanët dhe Leonardo është ofruar ta marrë në huazim me të drejtë blerjeje kundrejt 35 milionë eurove.

#### Monaco bën gati ofertën për Joao Marion

Mesfushori portugez Joao Mario duket se do të largohet në fund të sezonit nga Interi, ndërsa interes të fortë për të po shfaq skuadra e Monacos. Francezët kanë gati 25 milionë euro për ta blerë përfundimisht kartonin e tij.

#### Mourinho përjashton rikthimin në Premierligë

Të gjithë presin me kuriozitet të mësojnë se cila do të jetë skuadra e re e Jose Mourinhos, ndërsa portugezi ka përjashtuar një nga opsionet. Në një intervistë për transmetuesin "DAZN", Mourinho ka theksuar se nuk do të kthehet në Premierligë.

#### Wolfsburgu zgjedh trajnerin e ri

Skuadra gjermane e Wolfsburgut ka njoftuar se ka vendosur t'i besojë bankinën Oliver Glasnerit. Ish-trajneri i Linz-it ka nënshkruar kontratë trevjeçare dhe do të nisë punën në korrik.

#### Sane i pakënaqur te City, pritet largimi në verë

Sulmuesi anësor Leroy Sane nuk gëzon marrëdhënie të mira me Pep Guardiolen dhe pritet të largohet nga Manchesteri këtë verë. Për sulmuesin gjerman po shfaq interes të fortë skuadra e Bayernit.

#### Gattuso mohon zërat për një kalim në Angli

Trajneri i Milanit, Genaro Gattuso, ka mohuar zërat që e lidhin të ardhmen e tij me skuadrën angleze të Newcastle Unitedit. "Mendesin e kam mik dhe nuk e kam takuar për çështje pune. Unë mbetem trajner i Milanit", ka thënë Gattuso.





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
Ministry of Environment and Spatial Planning

### Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë për Kushtet Ndërtimore

**“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Në bazë të Ncni 13.1 të Udhëzimit Administrativ nr.16/2014 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Nr. prot: 1815/19 të datës 02.04.2019, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda njëzet ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

#### Posta rekomandë:

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
Ndërtesa e Rilindjes  
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Raporti mund të shkarkohet nga linku i mëposhtëm:

<http://mmp-hks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor  
Suzana.goranci@rks-gov.net  
Telefon: + 381 38 200 32 553

#### Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: **“Brigada 125”**

Komuna: **Prizren**

Data: **26.04.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
<b>ESIP/SDG/83-CS/1.7</b>	<b>Trajnim: Për aplikim të TIK-ut ne mësimdhënie</b>

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shfmu“Brigada 125” -Medvec, Prizren**. Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

#### Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe përsosjen e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

#### Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

#### Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore” të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).Firmat konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu“Brigada 125”- Medvec, Prizren, më së largu deri më datën: 08.05.2019**. Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

#### Detajet kontaktuese të shkollës:

**Personi kontaktues: Hamez Krasniqi**  
**Telefoni: 044/294-539**  
**E-maili: sh.f.brigada125@hotmail.com**

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “LOB” Sh.P.K, me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 810191437 me pronar Liridon Hasani dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavještavamo sve kliente da društvo “LOB ” D.O.O , sasedistem u Vushtrri, doneo odluku da ugasi biznis po br.registra: 810022393 Liridon Hasani, I ujdno imenovao Likfidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti imaju obaveze I potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company “LOB “ L.L.C, Vushtrri, has come to the decision to quit its business with registry 810022393- Liridon Hasani, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage-mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government  
Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/ Agency for Administration of Sequestrated and Confiscated Assets

### Ftesë për Ankand Publik

**Datë 25.04.2019**

**Referenca: AAPSK - 004/2019**

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:


Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1.	Kamion Man 19.403 FLT, viti i prodhimit 1995, dizel, ngjyre e bardhë, me targa vendore dhe gjysëm Rimorkio Kiper Schwarzmuller, Kippsattel viti i prodhimit 2007, ngjyre e hirit, me targa vendore - Rishpallje	Kamion me Rimorkio	9,750.00€		
2	Renault T.aguna viti i prodhimit 2002 dizel, ngjyre e hirit metalike, me targa vendore	1 copë	2,000.00€		
3	Peugeot 230 I. Boxer viti i prodhimit 1999 dizel, ngjyre e bardhe, me targa vendore	1 copë	750.00€		
4	Traktor Rakovice 65 dizel, ngjyre e kaltër me rimorkio klasike - për auto pjese	Traktor me Rimorkio/ për pjesë	700.00€		
5	Peshore Digjitale, marka Tanita, model 1479Z	1 copë	5.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri më 02.05.2019 në ora 10:00h, në lokalet e AAPSK-së, Divizioni i Shitjes (në adresën e poshtëshënuar). Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 30.04.2019, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë. Pasurit e konfiskuara në këtë procedurë shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me vete të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-sc,në: <https://md.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 10:00.

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 18 016.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

#### Zyra e Kryetarit /Kabinet Precednika / Office of the Mayor

Në bazë të dispozitave të nenit 4 paragrafi 1, 2 nënparagrafi 2.4.1 dhe 2.4.3.1 nenit 11 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/ L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr. 03/ L-205, të nenit 4, nenit 5, nenit 7, nenit 9, nenit 11, nenit 13, nenit 44 paragrafi 1.1, nenit 83 paragrafi 3, nenit 108 dhe 109 paragrafi 2, nenit 119 paragrafi 1 dhe nenit 123 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, nenit 13, nenit 17, nenit 58 nën a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 15 të statutit të Komunës së Skenderajt, Kryetari i Komunës së Skenderajt, z.Bekim Jashari, me dt.18.04.2019 nxjerrë këtë:

#### VENDIM PËRFUNDIMTAR

- I. Shpronësohen** paluajtshmëritë për interes publik, për realizim të projektit të rregullimit të rezervarit të ujësjellësit për nevoja të qytetit të Skenderajt, si vijon:
- Ngastra kadastrale nr.17-3 lloji i shfrytëzimit të pronës mal i klasës 3, me sipërfaqe prej 702m<sup>2</sup> Zona Kadastrale Ternac evidentuar sipas certifikatës së pronësisë nr.825-18, me pronar **Ferat (Rama) Sinani**.
  - Ngastra kadastrale nr.17-2 lloji i shfrytëzimit të pronës mal i klasës 3, me sipërfaqe prej 2762m<sup>2</sup> Zona Kadastrale Ternac evidentuar sipas certifikatës së pronësisë nr.825-18, me pronar **Ferat (Rama) Sinani**.
- II. Vërtetohet** se realizimi i projektit për rregullimin e rezervarit të ujësjellësit për nevoja të qytetit të Skenderajt, është qëllim i ligjshëm me interes publik dhe se shpronësimi i paluajtshmërisë së cekur në pikën I të këtij vendimi është në funksion të arritjes së të njëjtit qëllim.
- III. Pronari** i paluajtshmërisë së shpronësuar për pjesën e ngastrës kadastrale nr.17-3 për 1 m<sup>2</sup> pronë e shpronësuar kompensohet në shumën prej: **2.80 €** (dyeurotetëdhjetëcent), për sipërfaqen që shpronësohet prej: **702m<sup>2</sup>** pronë e shpronësuar kompensohet në shumën prej: **1,965.60€** (njëmijënjëntëqindëgjashetëdhjetëpesëeurogjashtëdhjetëcent), ndërsa për ngastrën kadastrale nr.17-2 për 1m<sup>2</sup>, pronë e shpronësuar kompensohet në shumën prej **2.80€** (dyeurotetëdhjetëcent), për sipërfaqen që shpronësohet prej **2762m<sup>2</sup>**, kompensohet në shumën prej **7,733.60€** (shtatë mijë e shtatëqindëtri dhjetëtri eurogjashtëdhjetëcent)
- IV. Vlerësimi** për kompensimin e pronës së paluajtshme që është objekt shpronësimi është bërë nga organi kompetent, respektivisht Ministria e Financave- Departamenti i Tatimit në Prishtinë.
- V. Për sprovimin** e vendimit do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Skenderajt.
- VI. Vendimi** hyn në fuqi ditën e shpalljes në një gazetë zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë metitrazh me të madh në Kosovë.

#### Arsyetim

Kryetari i Komunës së Skenderajt si organ Shpronësues Komunal me të drejtën Autoritative që i është dhënë me Ligj përkatësisht nga mbështetja në dispozitat e lartçekura, ka bërë iniciimin e Procedurës së Shpronësimit të Pronave të Paluajtshme në njësinë Kadastrale si në nenin një të

këtij Vendimi Përfundimtar, me qëllim të arritjes së qëllimit të ligjshëm Publik, për realizimin e projektit të rregullimit të rezervarit të ujësjellësit për nevoja të qytetit të Skenderajt, dhe se ky shpronësim ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e mirëqenies së përgjithshme shoqërore të banorëve të Komunës së Skenderajt, si dhe duke parë që për realizimin e këtij projekti për interes të përgjithshëm publik duhet të bëhet shpronësimi i pronave/parcelave kadastrale në Zonën Kadastrale Ternac, e që shpronësimi në fjalë prekë të drejtat private të pronarit, pjesët e pronave të paluajtshme të së cilit janë objekt shpronësimi nuk janë zgjedhur për arritjen e ndonjë qëllimi ose synimi diskriminues, kështu që Kryetari si organ shpronësues i ka përbushur të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij Ligji.

Po ashtu në afatin ligjor, organi shpronësues ka miratuar Vendimin Preliminar nr.02-463/01-0002877/19 të dt.16.01.2019, për shpronësimin e paluajtshmërisë së evidentuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për iniciimin e procedurës së shpronësimit dhe së kërkesa e subjektit kërkues për shpronësim është e bazuar, si dhe duke u mbështetur në arritjen e qëllimit të përfutimit të Ligjshëm Publik, të realizimit të projektit për rregullimin e rezervarit të ujësjellësit për nevoja të qytetit të Skenderajt dhe në mbështetje të dispozitave të lartshënuara u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi Përfundimtar.

**Udhëzime Juridike:** Kundër këtij Vendimi Përfundimtar, pala e pakënaqur ka të drejtën e paraqitjes së ankesës për kundërshtimin e tij, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-dega në Skenderaj, në afat prej 30 ditëve kalendarike pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Në të njëjtën ditë në të cilën parashtroesi i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtroesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtpërdrejt të dorëzojë në Zyrën Ligjore të Organit Shpronësues 5 (pesë) kopje të sakta dhe të plota të ankesës duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alineja 3 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr.03/L-139).

**SHTOJCË:** Vlerësimet nga Ministria e Financave-Departamenti i Tatimit në Pronë, i dt.19.03.2019, për pronën e paluajtshme të cekur në pikën 1 dhe 3 të këtij vendimi që është objekt shpronësimi. (**Bashkangjitur**).

02Nr. 464/01-0022799/19  
Skenderaj, më 19.04.2019

#### Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit
2. DGJKP-së
3. Pronarit të pronës së shpron.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

#### Zyra e Kryetarit /Kabinet Precednika / Office of the Mayor

Në bazë të kërkesës së DGJKP-së të Komunës së Skenderajt nr.05-464/01-0017744/19 të dt.27.03.2019, për iniciimin e procedurës së shpronësimit të pronës së paluajtshme private për interes publik, si dhe në bazë të dispozitave të nenit 4 paragrafi 1, paragrafi 2 nënparagrafi 2.4.3 dhe 2.4.3.3 nenit 10 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/L-205, të nenit 4, nenit 5, nenit 7, nenit 9, nenit 11, nenit 13, nenit 44 paragrafi 1.1, nenit 83 paragrafi 3, nenit 108 dhe 109 paragrafi 2, nenit 119 paragrafi 1 dhe nenit 123 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031, nenit 13, nenit 17, nenit 58 nën a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, si dhe nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt, Kryetari i Komunës së Skenderajt z.Bekim Jashari me dt.18.04.2019 nxjerrë këtë:

#### VENDIM PRELIMINAR

**I. Miratohet** Shpronësimi i pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale të Skenderajt, e evidentuar në pronësi të Ramadan (Arif) Murtezaj, parcela nr.268-8, në vendin e quajtur Rudinë e Bardhë-Jedina, kualiteti Arë e klasës 4, me sipërfaqe të përgjithshme 00.01.94. ha, për interes të ligjshëm publik, për realizimin e projektit të ndërtimit të rrugës për nevoja të Qytetit të Skenderajt, e parapare me planin Urbanistik të Komunës së Skenderajt.

**II. Obligohet** Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë t'i dërgojë Vendimin Preliminar pronarit që i është shpronësuar prona, Zotëruesit të interesit të Pronave dhe personave të tjerë që pretendojnë së u takon një e drejtë në pronën e shpronësuar, brenda pesë (5) ditëve të punës.

**III. Brenda** dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të vendimit Preliminar, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e shpallë vendimin në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me titrazh të madh në Kosovë.

**IV. Kundër** këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi ka të drejtë të paraqesë ankesë në Gjykatën Themelore në Skenderaj, çdo person i cili është Pronar ose Zotërues i Interesit në pronën e prekur nga ky vendim, si dhe ai i cili ka arsye të mira për mos besuar se Vendimi Preliminar është në Kundërshtim me një ose me shumë kushte të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 4, në përputhje me nenin 35 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/ L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr. 03/ L-205 të datës 28.10.2010 ( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.91.)

**V. Për zbatimin** e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtës së Ambientit.

**VI. Vendimi** hyn në fuqi ditën e publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me titrazh të madh në Kosovë.

**VII. Pjesë** e këtij vendimi janë certifikata e pronësisë nr.138-19 të dt.25.03.2019, kopja e planit e dt.05.11.2018, raportet e njësisë kadastrale të dt.26.03.2019, konfirmimi nr. 400/01-0017722/19 i

DFEZH-së për mjetet e planifikuara, si dhe përshkrimi detal i parcelave kadastrale që do të shpronësohen nga pika I e këtij vendimi.

#### Arsyetim

Kryetari i Komunës së Skenderajt pas kërkesës së DGJKP-së të Komunës së Skenderajt nr.05-464/01-0017744/19 të dt.27.03.2019, si organ Shpronësues Komunal me të drejtën Autoritative që i është dhënë me Ligj përkatësisht nga mbështetja në dispozitat e lartçekura, ka bërë iniciimin e Procedurës së Shpronësimit të Pronave të Paluajtshme në Zonën Kadastrale në Skenderaj, e evidentuar në pronësi të Ramadan (Arif) Murtezaj, parcela nr. 268-8, në vendin e quajtur Rudinë e Bardhë-Jedina, kualitet Arë e klasës 4, me sipërfaqe të përgjithshme 00.01.94. ha, për arritjen e qëllimit të ligjshëm Publik, ku iniciimi i kësaj procedure të shpronësimit ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e mirëqenies së përgjithshme të banorëve të Komunës së Skenderajt, si dhe duke parë që për realizimin e projektit të ndërtimit të rrugës për nevoja të Qytetit të Skenderajt me interes dhe qëllim të qartë të ligjshëm publik duhet të bëhet shpronësimi i pronës private/parcelës kadastrale në Zonën Kadastrale në Skenderaj, dhe se duke parë së shpronësimi në fjalë prekë të drejtat private, dhe së prona e paluajtshme si objekt shpronësimi nuk është zgjedhur për arritjen e ndonjë qëllimi ose synimi diskriminues, me kompetencë të plotë Kryetari i Komunës si organ shpronësues i ka përbushur të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij Ligji për iniciimin e kësaj procedure.

Gjithashtu pas një sërë takimesh me pronarin e pronës z. Ramadan (Arif) Murtezaj, ku i njëjti është deklaruar se nuk është kundër arritjes së qëllimit të Ligjshëm Publik me saktësisht realizim të projektit të ndërtimit të rrugës në Skenderaj.

Andaj duke u mbështetur në arritjen e qëllimit të përfutimit të Ligjshëm Publik, të realizimit të projektit të lartçekur dhe në mbështetje të dispozitave të lartshënuara u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi Preliminar.

**SHTOJCË:** Bashkangjitur të dhënat në formë tabelare për pronarin, numrin e ngastrës, sipërfaqen dhe vendndodhjen e pronës që do të shpronësohet, kopjen e certifikatës së pronës private, kopjen e planit, raportet e njësisë kadastrale.

02Nr. 464/01-0022799/19  
Skenderaj, më 19.04.2019

#### Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit
2. DGJKP-së
3. DU-së dhe
4. Palës





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA -VLADA-GOVERNMENT

MINISTRIA BUIQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

  
Agjencia Pyjore e Kosovës  
Agjencia za Šume Kosova  
Kosovo Forest Agency

Sektori i Burimeve Njerëzore  
Kancelarija osoblja i razvoja ljudskih resursa  
Office of Personnel and Human Resources Development

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës NR.03/L-149 dhe nenin 22, paragrafi 4 të Rregullorës Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, miratimit përmes SIMBNJ të pozitës nga MAP me datë 25.04.2019, bënë:

### RISHPALJEN E KONKURISIT PËR KËTË VEND PUNE

Titulli i pozitës: Zyrtar/e Ligjor/e 2  
Ref: APK-05/19  
Njësia organizative: Drejtorati Koordinues i APK në Gjilan  
Vendi i punës: Gjilan (1)  
Nëpunësi Mbikëqyrës: Drejtorati Ligjor -Drejtori i Drejtorisë Koordinuese në Gjilan -  
Kategoria funksionale: Niveli profesional  
Grada e pagës (Koefficienti): Grada 9, koefficienti 7  
Lloji i pozitës së punës: I/e Karrieres  
Kohëzgjatja e periudhës provuese: dymbëdhjetë(12) muaj

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Interpretim dhe përcjellje zbatimin e Ligjit për pyjet e Kosovës, aktet nënligjore, udhëzimet administrative në interes të DKR të APK-së.
- Përfaqësimi i DK te APK-së nëpër gjykata kompetente për përfaqësimin e lendeve lidhur me demet e pyjeve, tokave pyjore dhe kontesteve tjera gjyqësore, sipas padive të ushtruara ndaj APK si dhe të APK-së ndaj të tjerëve.
- Përpilimi dhe ushtrimi i propozimeve të përmbartimit të lendeve sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë në gjykata kompetente.
- Pranimi, evidentimi dhe ruajtja e vendimeve, aktvendimeve, aktgjykimeve dhe shkresave tjera të kësaj natyre të dërguar nëpër gjykata apo të ardhura prej tyre.
- Hartimi, përpunimi i raporteve të rregullta i fletëparaqitjeve të dëmeve pyjore (muajore dhe periodike-vjetore) për nevojat të APK qendër dhe nevojat të DK të APK.
- Përcjellja e evidencës së zgjidhjes së lëndëve në gjykata për dëme pyjore dhe dëme tjera në pyje dhe toka pyjore si dhe mbajtjen e shënimeve të dëmtuesve permanent.
- Në baze të kërkesës së Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme -Sektorit Përkatës të APK do të përgatis raportet dhe sqarimet e kërkuara nga auditorët e brendshëm dhe të jashtëm në nivel të Drejtorisë Koordinuese.
- Do të bashkëpunoj ngushtë me zyrtarin përkatës në APK qendër si dhe sipas nevojës do të i ndihmoj, zyrtarin për mbrojtje të pyjeve dhe shefat e njësive komunale të AP në interes të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve.
- Hartimi i kërkesave, ankesave, akteve dhe parashtrësive tjera juridike për zbatimin e procedurave përkatëse në favor të DK të APK.
- Realizimi dhe kryerja e punëve të tjera sipas urdhrit të Drejtorit të DKR dhe DL-APK.

#### Shkathtësitë kyçe, aftësitë dhe përvoja :

- Minimum dy vite përvojë pune
- Aftësi për vendimarrje, planifikim, vendosjen e prioritetëve në punë dhe vetë iniciativë
- Fleksibilitet dhe aftësi për të përballur me situata të reja;
- Njohja e kompjuterit dhe aftësia për të përdorur me efekt Microsoft Office, pajisjet tjera të zyrës
- Zotimi i një prej gjuhëve zyrtare në të shkruar dhe në të folur në Republikën e Kosovës
- Aftësi për punë ekipore dhe motivim të ekipit,
- Zotësi për punë në mjedise shumëtnike
- Aftësia dhe gatishmëria për bashkëpunim dhe punë në terren.
- Aftësia për evitimin dhe shmangjen e situatave konfliktuale.
- Aftësia dhe gatishmëria për punë nën presion.
- Aftësi për përgatitje të raporteve, shkresave, kërkesave dhe informatave zyrtare.
- Të mos jetë i gjykuar për vepra penale me vendim të formës së prerë si dhe të mos ketë të iniciuar aktakuzë të prokurorëve hetimorë penale.

#### Nëse kandidati ka punuar apo punon në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës:

- Të ketë vlerësime pozitive të punës në dy (2) vitet e fundit nga Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë
- Të mos jetë në procedurë disiplinore dhe të mos jetë i ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore në tri (3) vitet e fundit.

#### Kualifikimet arsimore dhe profesionale për këtë pozitë:

- Diplomë universitare -Fakulteti juridik (konformë Udhëzimit Administrativ (MASIIT) Nr.16/2016 për Parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe univeritare të fituara jashtë Republikës së Kosovës)

#### Procedura e Konkurrimit:

Është e hapur edhe për kandidatë jashtë Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës.

#### Procedura e Konkurrimit:

Është e hapur edhe për kandidatë jashtë Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës.

Data e shpalljes së konkursit: 26.04.2019

Data e mbylljes së konkursit: 10.05.2019

#### SQARIM :

Rishpallja e konkursit bëhet me arsyetimin se në shpalljen e më hershme të datës 19.03.2019 nuk ka pasur numër të mjaftueshëm të aplikacioneve që e plotësojnë kriterin e kandidatëve të përgjegjshëm për të vazhduar fazat tjera të procedurës së rekrutimit konformë nenit 22 paragrafi 4 i Rregullorës Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit NR.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

#### Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.

#### Dokumentet duhet të jenë fotokopje përndryshe nuk kthehen.

Procedura e Aplikimit: Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Sektorin e Burimeve Njerëzore, zyra nr.2 në Agjencinë Pyjore të Kosovës, Rr. Zenel Salihu 1/A Prishtinë (prapa Muzeut të Kosovës).

Për informacione tjera shtesë kontaktoni në telefonin nr. 038-200-38-482 çdo ditë pune prej orës 8.<sup>00</sup> deri 16.<sup>00</sup>.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA -VLADA-GOVERNMENT

MINISTRIA BUIQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

  
Agjencia Pyjore e Kosovës  
Agjencia za Šume Kosova  
Kosovo Forest Agency

Sektori i Burimeve Njerëzore  
Sektor Ljudskih Resursa  
Office of Personnel and Human Resources Development

Na osnovu Zakona za Civilnu Službu Republike Kosova Br.03/L-149, i člana 22, stav 4 Pravilnika Br.02/2010 za Procedure Rekrutovanja u Civilnoj Službi Republike Kosova i Usvajanja preko ISMJALJR, sa pozicija od MJA, dana 25.04.2019, Raspisuje:

### PONOVNO KONKURS ZA SLEDEĆE RADNO MESTO

Naziv pozicije: Pravni Službenik  
Ref: AŠK -05/19  
Organizaciona Jedinica: Koordinaciona Direkcija AŠK u Gnjilane  
Radno mesto: Gnjilane (1)  
Nadzorni Službenik: Direktor Pravne – Direktor Koordinacione Direkcije AŠK u Gnjilane  
Funksionalna kategorija: Profesionalni nivo  
Grada plate (Koefficient): Grada 9, koefficient 7  
Vrsta radne pozicije: KARIJERNE  
Probni Vremenski period: dvanaest ( 12) meseci

#### Zadaci i odgovornosti:

- Vrsi tumačenje i vrsi nadzor sprovođenje Zakona za Šume Kosova, podzakonskih akata, Administrativna Uprytstva u interesu RKD – AŠK –a.
- Zastupanje RKD- a - AŠK –a, u nadležnim sudovima i zastupanje sudskih predmeta u vezi šumskih šteta, šumskog zemljišta i drugih sudskih parnica, prema podnošenih prijava protiv AŠK- a i obrnuto.
- Izraduje i podnosi predloge za izvršenje predmeta po pravosnažnim sudskim odlukama donešenih od strane nadležnih sudova.
- Primanje, evidentiranje i čuvanje odlua, rešenja, presuda i drugih dopisa ove prirode, podnosetih po sudovima i primljene od strane raznih sudova.
- Izrada i obrada redovnih izveštaja prijava, šumskih šteta (mesečnih i periodičnih – godišnjih) za potrebe AŠK – centar i potreba RKD – AŠK –a.
- Praćenje evidencije rešenih predmeta po sudovima, za šumske štete i drugih šteta šteta i šumskih zemljišta ka i održavanje podataka stalnih štetnika.
- Na osnovu zahteva Direkcije Opšte Administracije – dotičnog Sektora AŠK- a, pripremiće izveštaje i objašnjenja zatražene od Unutrašnjih i Stranih Auditora na nivou RKD- a.
- Saradivaće usko sa odrđenim Službenikom AŠK- a – centar kao i po potrebi pomagaće Službenika za čuvanje šteta i Šefova Opštinskih Autoritete, od interesa stabilnog menadžiranja šteta.
- Izrada zahteva, žalbi, akata i drugih pravnih dopisa za sprovođenje dotičnih procedura U interesu RKD - AŠK- a.
- Realizacija i izvršenje drugih poslova po naredbu Direktor RKD- a i Direktora PID - AŠK- a.

#### Ključne veštine, sposobnosti i iskustvo :

- Maksimalno dve (2) godina radnog iskustva
- sposobnost za sprovođenje odluka, planova, ispostavljanje prioriteta na rad i samoinicijativu,
- Fleksibilitet i sposobnost da se suoči sa novim situacijama,
- Poznavanje kompjutera i sposobnost za efektnu upotrebu Microsoft Office, druga kancelarijska oprema,
- sposobnost upoznavanja jednog od službenog jezika pismeno i usmeno na Republici Kosova ,
- Sposobnost za timski rad i motivisanje tima,
- sposobnost i spremnost za saradnju i rad na terenu,
- sposobnost za rad u multietničkim sredinama,
- sposobnost za izbegavanje i otklanjanje konfliktnih situacija,
- sposobnost za pripremu izveštaja ,dopisa, zahteva i službenih informacija,
- da nije kažnjen za krivično delo sa pravosnažnom odlukom i da nije pokrenuta nikakva krivična istraga.

#### Ako su kandidati radili ili rade u Civilnoj Službi Republike Kosova:

- Dve (2) zadnje godine da ima pozitivne ocene od svog neposrednog rukovodioca,
- Da nije u disciplinskoj proceduri i da nije kažnjen sa disciplinskim merama u tri (3) zadnje godine.

#### Obrazovna i stručna kvalifikacija za ovu poziciju:

-Universitetska diploma-Pravni Fakultet (shodno Administrativnog Uputstva (MPNT) Br16/2016 za načela i procedura poznavanja diploma, činova i kvalifikacija visokih škola, visokih profesionalnih škola i univerzitetnih, dobijenih van Republike Kosova.)

#### Procedura konkurisanja:

Jeste otvorena i za kandidate van Civilne Službe Kosva.

Datum proglašenja konkursa, 26.04.2019

Datum zključenja konkursa, 10.05.2019

#### OBJAŠNJENJE:

Ponovno raspisavanje konkursa se vrsi sa razloga što na prethodnom objavljivanju dana 19.03.2019 nije bilo nedovoljnog broja prijava, odnosno nije bilo neophodan broj odgovarajućih aplikacija za nasatavak ostalih faza rekrutnih postupaka.

Civilna Kosovka Služba pruža jednake mogućnosti zaposlenja svim državljanima Kosova i prima aplikacije svih lica muškog i ženskog pola iz svih zajednica u Kosovo.

Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju prave da budu predstavljeni proporcionalno u organima Civilne Službe na nivou lokalne i centralne uprave, kao što je nažnačeno u član 11, stav 3 Zakona Br/03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova.

#### Nekompletirane dokumentacije se neće uzeti u obzir.

Dokumentit treba biti fotokopije jer se neće vratiti.

Postupak konkurisanja: Obrazci za konkurisanje se mogu dobiti i dostaviti Kancelarija osoblja i razvoja ljudskih resursa, kancelarija br.2 pri Agenciji za Šume Kosova, Ul. Zenel Salihu nr. 1/A Prishtina (iza Muzeja Kosova).

Za dodatne informacije kontaktirajte na telefon br. 038-200-38-482 svakog radnog dana od 8.<sup>00</sup> do 16.<sup>00</sup> časova.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Republic of Kosovo - Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova



KOMUNA E PRIZRENIT  
Prizren Belediyesi - Opština Prizren

**Nr. 01-111-59335**  
**Dt. 26.04.2019**

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 dhe nenit 18 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 3 i Rregullores Nr.02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Prizrenit, shpall:

### KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS TË JO KARRIERËS

#### Zyra e Kryetarit

#### 1. Titulli i pozitës së punës: Auditor i Brendshëm - AU/020

Numri i Ekzekutuesve: 1 (një)  
Kategoria Funksionale: Niveli Profesional 3  
Grada e vendit të punës: 8  
Koeficienti: 15  
Lloji i pozitës: Jo Karrierës  
Kohëzgjatja e emërimit: 2 vjet

#### Qëllimi i vendit të punës:

Brenda fushës profesionale, auditimit të brendshëm, aplikon përvojën në kryerjen e auditimit dhe detyrave përkatëse profesionale, duke punuar brenda të gjitha ligjeve, rregulloreve, politikave dhe procedurave në fushën e auditimit të brendshëm.

#### Detyrat kryesore:

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin merr pjesë në hartimin e planit të auditimit dhe miraton planin e punës dhe afatet për bërjen e auditimeve edhe shërbimeve përkatëse;
- Kryen/udhëheq auditime, përfshirë intervista hyrëse me sektorin që auditohet, interviston stafin, merr dhe analizon dokumentacionin përkatës dhe regjistron të gjeturat;
- Përgatit draft raportin, diskuton me mbikëqyrësin dhe bënë intervistën përfundimtare;
- Harton raportin final, me rekomandimet adekuate, finalizon dosjen e auditimit, dhe dorëzon atë për arkivim;
- Monitoron zbatimin e rekomandimeve nga ana e institucioneve dhe njësjive organizative;
- Ofron udhëzime për stafin e nivelit më të ulët në njësinë e auditimit të brendshëm për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre;
- Ofron këshilla për çështje të auditimit të brendshëm brenda institucionit, sipas nevojës;
- Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon me autoritetet e jashtme sipas nevojës.

#### Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e auditimeve;
  - Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
  - Shkathësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
  - Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

#### Kushtet:

- Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet, minimum 3 vite përvojë pune profesionale.
- Certifikatë e auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Republic of Kosovo - Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova



KOMUNA E PRIZRENIT  
Prizren Belediyesi - Opština Prizren

**Nr. 01-111-59342**  
**Datë: 26.04.2019**

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 dhe nenit 18 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 3 i Rregullores Nr.02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Prizrenit, shpall:

### KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

#### Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

#### 2. Titulli i pozitës së punës: Zyrtar për Digjitalizimin e Librave – PBS/570

Numri i Ekzekutuesve: 1 (një)  
Kategoria Funksionale: Niveli profesional 1  
Grada e vendit të punës: 10  
Koeficienti: 6  
Lloji i pozitës: Karrierës

#### Qëllimi i vendit të punës:

Zbaton strategjinë për zhvillimin e sektorit të përpunimit, katalogimit dhe digjitalizimit të librave në Bibliotekë.

#### Detyrat kryesore:

- Bënë regjistrimin e çdo materiali bibliotekar që hynë në bibliotekë,
- Përmes përpunimit bënë përcaktimin e fushës bibliografike,
- Siguron regjistrimin e çdo libri të hyrë dhe të dalë nga biblioteka,
- Siguron përpilimin e regjistrimit të librave të humbur për plotësimin e tyre me fotokopje,
- Bënë katalogimin e librave sipas KUD-it,
- Ruan në formë digjitalc materialet bibliotekare,
- Në bashkëpunim me udhëheqësin harton planin zhvillimor të sektorit përkatës,
- Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

#### Shkathësitë e kërkuara:

- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse që i ndihmon procesit të punës;
- Shkathësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë;
- Shkathësi kompjuterike të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).

#### Kushtet:

- Diplomë universitare të fakultetit Ekonomik, Juridik, Administratë publike, Edukim, Shkenca Kompjuterike, Filologjik, pa përvojë pune ose Shkollë e lartë me 2 vite përvojë pune;

#### Dokumentacioni i kërkuar:

- Fotokopja e vërtetuar e diplomës (Formati A4);
- Vërtetim mbi përvojën e punës;
- Dy - rekomandime;
- Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
- Certifikata e lindjes;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikata të ndryshme.

**Konkursi ngel i hapur 15 ditë kalendarike** nga dita e publikimit, duke filluar nga data e publikimit më **26.04.2019** deri më datën **10.05.2019** që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

**Instrukione Aplikimi:** Kërkesa (Aplikacioni) për punësim gjendet në <http://kk.rks-gov.net/prizren/Shpalljet/Konkurset.aspx>, dhe pas plotësimit sipas çdo pike të aplikacionit, i bashkëngjiten dokumentet të cilat kërkohen sipas konkursit dhe mund të aplikoni tek ne drejtpërdrejtë - Adresa jonë: në sportelin e pranimi nr. 2, në objektin e administratës komunale në Komunën e Prizrenit, rr. "Remzi Ademaj" p.n. -Prizren. **VËMENDJE:** Njoftimet i gjeni në Ueb, ndërsa në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038 / 200 44715 prej orës 08:00 – 16:00. Aplikacionet e pranura pas afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen me shkrim (e-mail) në rast të mos konfirmimit të kandidatit në e-mail do të njoftohet me telefon dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para komisionit, në rast të mos sjelljes të dokumentacionit origjinal intervistues, kandidatët nuk do të mund të vazhdojnë në hapat e mëtejshme të procedurave të rekrutimit. Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Zyra e Personelit



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Republic of Kosovo - Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova



KOMUNA E PRIZRENIT  
Prizren Belediyesi - Opština Prizren

Nr. 01-111-59332  
Datë: 25.04.2019

Në bazë të nenit 18 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 4 paragrafi 5 i Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, neni 5 paragrafi 2 i Rregullores Nr. 21/2012 për avancimin në karrierë të nëpunësve civil, Komuna e Prizrenit, shpall:

### KONKURS PËR AVANCIM BRENDA INSTITUCIONIT PËR PLOTËSIMIN E POZITËS SË LIRË

Drejtorja e Punës dhe Mirëqenies Sociale  
Titulli i pozitës së punës: Drejtor i Qendrës për Punë Sociale - MSK/110 / JP00038861  
Pozita: e karrierës  
Numri i Ekzekutuesve: 1 (një)  
Kategoria Funktionale: Niveli drejtues  
Grada/Koeficienti: 8,5

#### Qëllimi i vendit të punës:

- Sigurimi i ofrimit të kujdesit dhe shërbimeve sociale për personat me nevojë

#### Detyrat kryesore:

9. Udhëheqje punën e përgjithshme të sektorit dhe ndihmon drejtorin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave si dhe harton planin e punës për sektorin,;
10. Mënaxhon stafin e sektorit, dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, si dhe ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit,;
11. Në bashkëpunim me drejtorin, bënë vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
12. Shqyrton ankesat e palëve të pakënaqur lidhur me refuzimin e të drejtës për ndihmë sociale nga nëpunësi i ndihmës sociale; Ruan në formë digjitale materialet bibliotekare,
13. Përcjellë nevojat sociale në mënyrë që të caktohen prioritetet e punës dhe që të sigurohet mirëqenia sociale duke përfshirë të gjithë qytetarët e në veçanti personat me nevoja të veçanta;
14. Nënshkruan të gjitha aktvendimet lidhur me njohjen apo refuzimin e ndonjë të drejte në ndihmë sociale dhe shërbime sociale dhe kujdeset që të mbrohen ato të drejta të garantuara;
15. Është i autorizuar të paraqes kërkesë para gjykatës për të shqiptuar një urdhër kujdestarie për fëmijët e abuzuar apo të lënë pas dore
16. Bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerjen e detyrave në përputhje me standardet e kërkuara;

#### Kushtet:

- Diplomë universitare, drejtimi: juridik, psikologji, pedagogji, sociologji, punëtorë social dhe 5 vite përvojë pune.

#### Shkathësitë e kërkuara:

- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim;
- Shkathësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë;
- Shkathësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose grup punues;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access).
- Njohja e gjuhës angleze.

#### Dokumentacioni i kërkuar:

- Fotokopja e vërtetuar e diplomës (Formati A4);
- Vërtetim mbi përvojën e punës;
- Dy - rekomandime;
- Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
- Certifikata e lindjes;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikata të ndryshme.

**Konkursi ngel i hapur 8 ditë kalendarike** nga dita e publikimit, duke filluar nga data e publikimit më 26.04.2019 deri më datën 03.05.2019 që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit. Të drejtë konkurrimi kanë vetëm të punësuarit në Institucionin e Komunës së Prizrenit. Komuna e Prizrenit ofron mundësi të barabarta për të gjithë nëpunësit civil ekzistues brenda Komunës. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregullores Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë.

**Instruksione Aplikimi:** Kërkesa (Aplikacioni) për punësim gjendet në <https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konkurset-njoftimet/aplikacione/>, dhe pas plotësimit sipas çdo pike të aplikacionit, i bashkëngjitni dokumentet të cilat kërkohen sipas konkursit dhe mund të aplikoni tek ne drejtpërdrejtë në sportelin e pranimit nr. 2, në objektin e administratës komunale në Komunën e Prizrenit, rr. "Remzi Ademaj" p.n. -Prizren. **VËMENDJE:** Njoftimet i gjeni në Ueb, ndërsa në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038 / 200 44715 prej orës 08:00 – 16:00. Aplikacionet e pranuar pas afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve.

Zyra e Personelit

C. nr.130/19

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË** Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me Gjyqtarin Ahmet Idrizaj, duke vendosur në çështjen juridike të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, rr. "Lidhja e Pejës" (te terminali doganor) p.nr. 10000 Prishtinë, kundër të paditurit Orland Gashi, më parë nga Gjakova, tani me adresë të panjohur, për: rimbursim demi, vlera e kontestit 947,00 Euro, sipas dispozitës ligjore të nenit 79.3 nën paragraf. a) dhe b) lidhur me nenin 86 të LPK, me datë 06.03.2019, mori këtë:

#### AKTVENDIM

Të paditurit Orland Gashi, më parë nga Gjakova, tani me adresë të panjohur, i **CAKTOHET** përfaqësuesi i përkohshëm Avdi Rizvanolli, avokat në Gjakovë, i cili ka për obligim që të paditurin në fjalë të e përfaqëson në procedurën civile në lëndën C.nr.130/2019, sipas padisë të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, me bazë juridike: rimbursim demi, dhe atë gjer në momentin kur i padituri i lartë përmendur, personalisht apo eventualisht ndonjë i autorizuar i tij nuk lajmërohet në Gjykatë, ashtu që përfaqësuesi i përkohshëm mund t' i ndërmerr të gjitha veprimet procedurale për të paditurin në fjalë të paraparë në bazë të Ligjit.

Andaj luteni që përmbajtjen e këtij Aktvendimi siç është cekur më lartë ta publikoni në Gazetën zyrtare të Kosovës dhe në ndonjërin nga të përditshmet ditore dhe lidhur me këtë të e njoftoni Gjykatën. Ky Aktvendim njëherit të publikohet edhe në tabelën e shpalljeve të kësaj Gjykate.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
C.nr.130/2019, datë 06.03.2019



Certified translation from Albanian language

C.no.130/19

**BASIC COURT IN GJAKOVË** General department – Civil division, with Judge Ahmet Idrizaj, upon deciding in the matter of the claimant Kosovo Insurance Bureau (KIB), seated in Prishtinë, Lidhja e Pejës Str. (next to the customs terminal) n.no. 10000 Prishtinë, against the respondent Orland Gashi, formerly from Gjakova, current address unknown, pertaining to damage reimbursement, value of contest € 947.00 pursuant to the provision of Article 79.3 sub-paragraphs a) and b) in conjunction with Article 86 of the Law on Contested Procedure (LCP), on 06.03.2019 rendered the following:

#### RULING

Avdi Rizvanolli, attorney in Gjakovë, is **APPOINTED** as the provisional representative of the respondent Orland Gashi, formerly from Gjakova, current address unknown. The provisional representative is obliged to represent the foregoing respondent in the civil procedure case C.no.130/2019, pursuant to the claim of the claimant Kosovo Insurance Bureau (KIB), seated in Prishtinë, on the ground of damage reimbursement, until the moment the aforementioned respondent or his authorized representative doesn't appear before the court. The provisional representative may undertake on behalf of the respondent all the procedural actions as provided by the Law.

Therefore you are kindly asked to publish the content of this Ruling in the Official Gazette of the Republic of Kosovo and in one of the daily newspapers and notify the court about this. This Ruling shall also be published in the announcement board of this court.

**BASIC COURT IN GJAKOVË**  
C.no.130/2019 on 06.03.2019

**JUDGE**  
Ahmet Idrizaj  
[Stamp and signature]





C.nr.312/2018

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC**, e përbërë nga kryetari i trupit gjykues, gjykatësi Betim Behluli, në çështjen juridike të paditësit Asllan Sahitaj-Calagnile nga fshati Qifllak, komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar avokati Sefer Morina, kundër të paditurës Rosaria Calcagnile nga qyteti i Dortmundit, Republika e Gjermanisë, për shkak të zgjidhjes së martesës-shkurorëzimit, më 10.04.2019, morri këtë:

**AKTVENDIM**

Të paditurës Rosaria Calcagnile nga qyteti i Dortmundit, Republika e Gjermanisë, i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm avokati Agim Metbala nga Rahoveci.

**Arsyetim**

Paditësi Asllan Sahitaj-Calagnile nga fshati Qifllak, komuna e Rahovecit, kësaj gjykate i ka ushtruar padinë kundër të paditurës Rosaria Calcagnile nga qyteti i Dortmundit, Republika e Gjermanisë, për shkak të zgjidhjes së martesës-shkurorëzimit.

Në bazë të padisë të paditësit Asllan Sahitaj-Calagnile, kjo gjykatë ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datën 27.02.2019, e meqenëse të gjitha shkresat dhe ftesa janë kthyer me konstatim se e paditura Rosaria Calcagnile nga qyteti i Dortmundit, Republika e Gjermanisë me adresë të pa njohur, në anën tjetër paditësi pranon që të bëhet shkurorëzimi dhe zgjidhja e martesës e në anën tjetër me propozimin e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, gjykata e miratoi propozimin e përfaqësuesit të paditësit dhe të paditurës Rosaria Calcagnile ia caktoi përfaqësuesin e përkohshëm avokatin Agim Metbala.

Duke marrë për bazë këtë gjendje faktike e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 79.3 a) të LPK-së, në anën tjetër duke marrë për bazë natyrën e lëndës urgjente, vendosi që të paditurit t'i caktoi përfaqësuesin e përkohshëm.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA RAHOVEC, C.nr. 312/2018, më, 10.04.2019**

**LAJMËROJ**

Bashkëpronaren **BAHRIJE LAQI** nga Prizreni si Blerësen potenciale se, Unë **MESTAN (Vehbi) FERIZI** si bashkëpronarë ligjor i ngastrës kadastrale me numër **P-71813068-06616-12**, që ka sipërfaqe të përgjithshme prej 569m<sup>2</sup>, me kulturë Arë e klasës 2, vendi i quajtur “Pashaallti”, Zona Kadastrale Prizren, me pjesë ideale prej 15/36, po e SHES – pjesën time bashkëpronësore gjegjësisht sipërfaqen prej 237m<sup>2</sup>.

Në këtë mënyrë i ofroj bashkëpronarve, poqë se janë të interesuar për blerje, të më lajmërohen në afat prej 30 ditëve, në adresë: rr.Bajram Kelmendi nr.23 – Prizren.

Një herri informoj se, e kam Blerësin potencial i cili brenda afatit prej 30 ditëve do ta pagu- -an çmimin e përgjithshëm prej 40.000,00 € (dyzetë mijë euro) me para të gatshme-në kesh.

Telefoni kontaktues:+383 (0) 45/663-980

Shpallje për gazetë

Ofertë për shitjen e patundshmërisë

**1.Nazim (Milazim) Berisha**, nga Prizreni, me banim në rr.”N.Seharsoj” nr.33. i pajisur me letërnjoftim – numër personal 1006760194 të lëshuar nga MPB e Kosovës – Prishtinë, është bashkëpronar me pjesën prej 89/99 e pjesës ideale (rreth 1777 m<sup>2</sup>) të patundshmërisë, me numër të Njësisë kadastrale P-71813046-00399-0, në vendin e quajtur “Rashko blato-do jaruge”, me kulturë bujqësore arë e kl.4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1977 m<sup>2</sup>, Zona kadastrale Lubizhdë.

Nga pjesa e vet ideale oferton për shitje tërë sipërfaqen prej 89/99 e pj.ideale ( prej 1777 m<sup>2</sup>) të patundshmërisë me të dhënat si më lart, në shumën e përgjithshme prej 35.540 € (me shkronjat Tridhjet e pesë mijë e pesë qind e katërdhjetë euro).

Prizren, 25.04.2019

Ofertuesi,  
Nazim Berisha

**Njoftimi për shprehje të interesit**

**Emri i shkollës:** “Dëshmorët e Vrrinit”- Billushë  
**Komuna:** Prizren  
**Data:** 26 Prill 2019  
**Emri i kontratës:** Vizitat shkencore, historike dhe sportive (Dragash- Brod, Ulpian-Prishtinë dhe visit në Brezovic)  
**Numri i kontratës:** ESIP/C1.3/084 - ESIP/SDG/84-CS/1.3

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës “**Dëshmorët e Vrrinit**”-Billushë, Prizren. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimeve të nevojshëm:

1. Përshkrimi i shërbimeve të nevojshëm:

- Kompani te udhetimeve( autobus) per realizimin e vizites.

Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e nje kontrate për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik dhe termeve të referencës në adresën e Shkollës “**Dëshmorët e Vrrinit**”-Billushë, Prizren më së largu deri më 08 Maj 2019.

Specifikimi i hollësishëm teknik dhe termet e referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t’ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t’i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

**Personi kontaktues:** Violeta Dervishaj  
**Telefoni:** 044/523867  
**E-maili:** floringashi1968@gmail.com

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Drenusha Rustemaj shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Shote Galica" Runik.

► Xheladin Avdullahi shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Faik Draga" Leqin.

► Vesel Çerkini shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Kuvendi i Drenices" Abri e Poshtme.

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m<sup>2</sup> me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m<sup>2</sup> për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.